



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	Vendi	Shtojca
	22.07.2024	Kaçanik	
Mj. org.	Niveli		
	01-104/02-1115	124	

**RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
PËR PERIUDHËN JANAR – QËRSHOR 2024**

Korrik/2024

FJALLA E KRYETARIT

Të nderuar qytetar, kam nderin që përmes këtij dokumenti, të raportoj për punën dhe aktivitetet komunale të realizuara gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024.

Edhe gjatë periudhës së lartëcekur na përcolli vizioni për përsosmëri në ofrimin e shërbimeve, përfshirjen e qytetarëve, barazinë, llogaridhënien, qëndrueshmërinë, punën në grup, transparencën, sigurinë në punë dhe respektin e ndërsjellë”.

Të gjitha punët tona, janë realizuar mbi parimin e transparencës dhe llogaridhënies, elemente këto tashmë të shndërruara në mekanizëm jehk për qeverisjen tonë. Profesionalizmi, ligjshmëria, integriteti dhe etika gjatë proceseve vendimmarrëse në komuna, garantojnë llogaridhënie dhe përgjegjshmëri institucionale ndaj qytetarëve.

Këto mekanizma janë instaluar dhe përkrahen fuqishëm në çdo sferë duke përfshirë shërbimet administrative dhe menaxhimin e projekteve kapitale.

Në vijimësinë e këtij raporti, do të njoftoheni me të gjitha punët dhe projektet komunale të realizuara gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024. Këto aktivitete janë përmbyshur në përputhje të plotë me autorizimet ligjore që kam si Kryetar i Komunës siç janë realizimi i shumë projekteve infrastrukturore, si rrugë me trotuare e ndriçim, ujësjellës e kanalizime, investime në sektorin bujqësorë, në infrastrukturën arsimore, kulturore e sportive.

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi



Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Një nga synimet kryesore të administratës komunale është arritja e efikasitetit në të gjitha nivelet. Institucionet publike janë përgjegjëse për të siguruar të mirat dhe shërbimet e nevojshme publike për qytetarët pa asnjë diskriminim. Prandaj objektivat shumë dimensionale të administratës komunale kërkojnë që performanca jo vetëm të jetë e kufizuar në ofrimin e shërbimeve, por gjithashtu të përfshijë elementin thelbësor të sigurimit të vlerave llogaridhënëse për qytetarët.

Në kohën bashkëkohore, pikepamjet e duhura se si duhet të funksionoj administrata komunale orientohen kryesisht në përpunimin në teknologji që priet të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në evolucionin e ofrimit të shërbimeve si një fushë dinamike e së ardhmes.

Drejtoria e Administratës është tradicionalisht e angazhuar në arritjen e efikasitetit në punën e dikastereve të saj, me theks të veçantë në ofrimin e shërbimeve. Prandaj, efikasiteti gjen një vend të përhershëm në planin dhe programin qeverisjes lokale. Efikasiteti dhe efigjenca merr një vemendje të rëndësishme kur përpigemi ta aplikojmë atë në një sistem që bazohet në shumë vlera, profesionalizëm e transparencë të zyrtarëve të angazhuar publik. Dimensioni i transparencës i jep një perspektivë unike efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Drejtoria e Administratës përkushtimin e saj e bazon në tri shtylla: efikasitet, performancë, transparencë. Këto mekanizma janë instaluar dhe vazhdojnë të përkrahen nëpërmjet investimeve kapitale në vazhdimësi. Investime këto kryesisht në teknologji, infrastrukturë të objektit dhe investime tjera të rëndësishme. Mbi këto parime, DAP ka ushtruar funksionin e saj statutor dhe në këtë raport shfaqet puna 6 mujore e kësaj drejtorie bashkë me sektorët e saj sipas organogramit.

Qendra Komunale për Shërbime me Qytetar

Njëra ndër sektorët më vital për funksionimin e duhur të institucionit lokal është Qendra për Shërbime me Qytetar.

Më poshtë mund të shihni tabelën e detajuar të lëndëve :

Tab.1 . Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes 01/01/2024-30/06/2024

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	7	161	805	2	0	0	0	0	8,300	9,275
DA	Drejtoria e Arsimit	5	568	146	20	1	5	1	17	0	763
DBZHRP	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylkansë	1	112	123	6	0	0	0	0	0	242
DBF	Drejtoria e Buxhettit dhe Financave	1	205	484	0	0	0	0	1	0	691
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	4	58	80	0	0	0	0	0	0	142
DESHP	Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike	11	4	264	20	0	0	0	2	0	301
DUKMM	Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	25	2,335	16	0	0	0	0	5	0	2,381
SHK	Shërbimi i Kryetarit	33	730	305	91	1	0	2	2	0	1,164
DKRS	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	3	34	0	0	0	0	0	1	0	38
DZHET	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	1	1	21	1	0	0	0	0	0	24
		91	4,208	2,244	140	2	5	3	28	8,300	15,021

Zyra Komunale e Gjendjes Civile

Zyra Komunale e Gjendjes Civile për periudhën 6 mujore ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e saja në bazë të autorizimeve ligjore si në vijim:

Përshtkrimi	
6568	Ekstrakte të Lindjes
2130	Certifikata të Lindjes
1256	Certifikata e Martesës
423	Certifikata e Vdekjes
167	Certifikata e Gjendjes Martesore
1283	Deklarata Familjare
839	Certifikata e Vendbanimit
70	Certifikata e Shtetësisë
231	Vertetime të Arkivit
52	Deshmi Vdekje
Totali: 13.019	

Tab. 2. Numri i certifikatave të lëshuara nga data 01/01/2024-30/06/2024.

Përshkrimi	Copë
Regjistrime të Lindjes të Rregullta	06
Regjistrime të Lindjes të Veçanta	93
Shpallje të martesave	122
Kurorëzime	122
Kurorëzime speciale	45
Regjistrime të vdekjes të rregullta	24
Regjistrime të vdekjes speciale	12
Lëndë të kompletuara për fitim të shtetësisë	14
Lëndë të kompletuara për humbje të shtetësisë	01
Vendime të ndryshme	46

Tab. 3. Numri i akteve të lëshuara nga data 01/01/2024-30/06/2024.

Në kuadër të punës të ZKGJC janë përgatitur statistikat mujore dhe janë dërguar me kohë në Agjencionin e Statistikave të Kosovës si dhe të gjitha gabimet për përmirësim janë dërguar me kohë në ARC.

Janë mbajtur takime në lidhje me problemet dhe vështirësitë e ndryshme që përcjellin punën e përditshme të kësaj zyre.

Jemi kujdesur për funksionimin e rregullt të e-kisokut dhe furnizimin me kohë me çertifikata, kemi miratuar me kohë lëndët në internet për sektorin e Gjendjes Civile.

Gjithashtu janë vizituar herë pas here edhe zyret e gjendjes civile të cilat operojnë në terrenin e komunës sonë.

Arkivi

Sektori Arkivit gjatë këtij gjashtëmujori ka punuar si në vijmë:

PUNË NË ZYRE :

- Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët.

- Punimin e librave Arkivor.

- Punimin e listës me afate të ruajtjes së dokumentacionit, ku ka marrë pëlqimin edhe nga vet institucioni qëndror Agjencioni Shtetror i Arkivave të Kosovës.

- Nga zyra e gjendjes civile kemi pranuar dokumentacion në arkiv si në vijim:

Regjistrimet të rregullta dhe speciale të lindjeve, martesave, vdekjeve 2014-2022, aktgjykimet e shkurorzimeve për personat mbi moshën 18 vjet dhe vendimet për fitimin e shtetësisë, vendime për anulime 2018-2022 (gjithsej 151 kutia).

- Nga zyra e shërbimit me qytetarë kemi pranuar 11 libra protokolli.

- Nga zyra e kuvendit kemi pranuar të gjithë materialin në form libri nga viti 2001-2013

(gjithsej 59 copë).

PUNË NË DEPO :

Sipas kërkesave kemi bërë hulumtimin për gjetjen e lëndëve arkivore dhe kthimin e tyre në vendin përkatës si dhe mirëmbajtjen e lëndëve arkivore sipas njësisë punuese.

KËRKESA INTERNE janë parashtruar 40 kërkesa interne :

Për gjetjen e lëndëve nga lëmia e financave, projekteve të ndryshme shoqrore, prokurimi, leje të ndërtimit, drejtoria e urbanizmit, sektori i gjendjes civile etj.

KËRKESA TË PARASHTRUARA NGA PALË janë parashtruar 71 kërkesa :

Prej tyre 12 kanë qenë për stazh pune, 3 kanë qenë vertetime dhe përshkrim dokumenti kurse 3 kanë qenë verifikim i cili është kërkuar nga ana e Misnistrisë e Mirëqenjës Sociale - Departamenti për Pensione . Kërkesat tjera janë adesuar më së shumti sa i perket aktvendimeve të ndryshme për ndërrim të emrit, mbiemrit, lindjeve të jashtme, letërnjoftime të lëshuara para 1999, dokumentacion nga lëmi i lëndve shpronësoro- juridike, uzurpimeve, leje të ndërtimit etj. Palëve të interesuara ju kemi dhënë udhëzime profesionale konform ligjit për Arkivat dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Mirëmbajtja e objektit dhe autoparku

DAP nëpërmjet sektorit teknik, është përkujdesur për higjienën, pastërtinë e objektit të administratës komunale, mirëmbajtjen e sistemit të ngrohjes, mirëmbajtjen e aseteve etj.

Veturat zyrtare kanë qenë në gjendje të rregullt të regjistruara , servisuara dhe furnizuara me derivate, si dhe në dispozicion për të gjithë zyrtarët publik përgjatë periudhës për të cilën raportojm.

DAP gjithashtu ka filluar edhe realizimin e projekteve të parapara si :

- 1- "Renovimi i tualeteve në objektin e administratës komunale".
- 2- "Rregullimi i ashensoreve dhe qasja më e lehtë e personave me aftësi të kufiuara në objektin e administratës komunale".
- 3- Ndërsa sa i përketë projektit " Parkingu Nëntoksorë në oborrin e administratës komunale", i cili është ndaluar me vendim të MKRS pas disa gjetjeve arkeologjike në vitin 2023 .
Pas takimeve dhe shkresave me organet kompetente në këtë zone do të zgjerohen hulumtimet dhe pastaj do të vendoset si të vepohet tutje.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Puna gjatë periudhës JANAR- QERSHOR 2024 në QKMF "Dëshmoret e Lirisë" ka shkuar mirë. Të gjitha shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve janë kryer me rregull.

Vizitat shtëpijake për të sëmurët në stadin terminal të kancerit, si dhe të sëmurët e palëvizshëm kanë vazhduar edhe në këtë periudhë.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe vizitat shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç.

Gjatë periudhës janar - qershor 2024 në QKMF dhe terren janë kryer gjithsej 99 658-shërbime shëndetësore.

Prej tyre janë kryer 44906 kontrolla mjekësore, 55992-shërbime infermierike, janë referuar për në spital 4771 raste. Në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore 16539 pacientë. Injeksione 20239, infuzione 10380, lidhje dhe pastrim të plagëve 6954, janë bërë 3061 Ekg-ja, inhalime 1471. Janë

realizuar 1682 vizita shtëpijake, 921-vizita shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç.

Përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet 6302, shërbime të cilat janë realizuar në QKMF. Njesia e vaksinimit 3256 shërbime, si dhe tek shëndeti oral, 601-kontrolla

mjekësore stomatologjike. Në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike në QMF-Doganaj 159 pacientë, ndërsa në QKMF 6803 pacientë. Në njësinë e rëntgenit 2356 pacientë, pediatria 2401 paciente, gjinekologjia 1069 pacientë, pulmologjia 366 pacientë, radiologjia 229 pacientë.

Sa i përket participimit, gjatë muajit maj-qershor janë realizuar 3743 € të hyra në QKMF.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë gjatë periudhës janar -qershor ka qenë i mirë, por jo në nivelin e dëshiruar.

Gjatë periudhës janar - qershor, janë mbajtur ligjërata për stafin shëndetësor në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Në muajin prill 2024 (me 16.04.2024) është bërë rihapja e QMF-Doganaj, projekti i cili është financuar në tërësi nga komuna dhe ka kushtuar 113.000€.

Në periudhën janar-qershor 2024, QKMF-ja është futur në projektin në kuadër të fazes së III-të të AQH-së, ku kemi pasur vizita të ekspertëve të AQH-së, si dhe janë mbajtur trajnime për stafin shëndetësor lidhur me implementimin e këtij projekti.

Me datën 12 mars 2024 kam pranuar zyrtarisht njoftimin se QKMF-Kaçanik është përzgjedhë në projektin ICARS-MSH për përmirësimin e cilësisë së përshkrimit të antibiotikëve në Kujdesin Primar Shëndetësor. Ky projekt do të implementohet nga IKSHPK-ja me koordinator Prof.Dr.Lul Rakën.

Me datën 29 maj 2024 është mbajtë punëtorja në organizim të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me procesin e përzgjedhjes së mjekut familjar në tërë territorin e Kosovës, si dhe përgjegjësitë e Drejtorëve të QKMF-së, lidhur me këtë proces.

Gjatë periudhës janar-qershor 2024 ka filluar edhe vaksinimi kundër HPV-së (virusi i papillomës humane) për nxënësit e klasave të gjashta.HPV është shkaktar i kancerit të qafës së mitrës dhe përmes vaksinimit synohet që të parandalohet.

Me datë 04.06.2024, Drejtori i QKMF-së, Dr.Sinan Zeneli është takuar me KFOR-in polak dhe e kanë informuar se i janë përgjigjur pozitivisht kërkesën për veturë 4x4 dhe se me përfundimin e të gjitha procedurave nga ana e tyre në periudhën sa më të shpejtë do ta sjellin donacionin për QKMF-në.Kjo veturë do të shërbejë për bartjen e pacientëve për në Spitalin e Ferizajit për të kryer hemodializën .

Me datën 14.06.2024 është mbajtë ushtrimi fushor i Rajonit të Ferizajit për emergjenca, ushtrim I cili është mbajtë në fshatin Gërlicë dhe është organizuar nga DSHMS-ja e Ferizajit.Në këtë trajnim kanë marrë pjesë ekipet emergjente nga Spitali i Ferizajit,QKMF-Ferizaj,QKMF-Kaçanik,QKMF-

Viti, QKMF-Shtime, QKMF-Hani i Elezit, Policia dhe Zjarrëfikësit. Pas trajnimit janë shpërndarë mirënjohje për ekipet e urgjencës, që kanë qenë pjesëmarrëse në këtë ushtrim fushor. Me datën 20.06.2024 kemi marrë pjesë në takimin e parë të projektit ICARS-MSH për përmirësimin e cilësisë së përshkrimit të antibiotikëve në Kujdesin Primar Shëndetësor. Në këtë projekt janë të përfshirë QKMF-Prishtinë, QKMF-Lipjan, QKMF-Gjakovë, QKMF-Vushtrri, QKMF-Klinë dhe QKMF-Kaçanik.

Gjatë periudhës janar-qershor 2024 kanë filluar punën edhe 2 (dy) laborante mjekësore. Pas rritjes së stafit në laborator është mundësuar edhe hapja e laboratorit në QMF-Doganaj dhe ti ofrojmë qytetarëve shërbime nga e hëna deri të premten.

Qendra Per Pune Sociale përbëhet nga dy sektorë : **Sherbimi Social dhe** **Asistenca Sociale**

SHËRBIMI SOCIAL - Gjatë muajit Janar në zyrën e Shërbimit Social janë kryer këto shërbime:

- 08 Vërtetim për zotësi veprimi
- 06 Vërtetim për Heqjen e Shtetësis së Kosovës
- 01 Ftesa për seancë nga Gjykata për marrjen e zotesisë së veprimit.
- 06 Vizita në familjet të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përherëshme (FAKP)
- 01 Kontaktime të fëmijëve me prindërit të bashkëshortëve të shkurorëzuar
- 11 Lëndë janë regjistruar në Bazën e Shërbimeve Sociale.
- 03 Raporte për delikuent dërguar gjykatës
- 03 Kontaktime, ndërmjetime me QPS Ferizaj.
- 05 Vizita në teren për rregullimin e marrdhënjeve bashkëshortore tek rastet e dhunës në familje dhe raste tjera që janë në procedurë të shkurorëzimit.
- 02 Delikuent, QPS ja pjesmarrës në intervistim në SHPK stacioni policor Kacanik dhe trajtimi i rastit.

Kemi pasur raste dhe këshillime profesionale të ndarjes së bashkëshortëve, të cilëve u janë marr deklaratat dhe u janë dhënë këshilla profesionale për procedura të me tutjeshme . Punë tjera të përditshme si organ këshilldhënës lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të gjitha kategoritë.

ASISTENCA SOCIALE - në zyret e asistencës sociale janë kryer këto shërbime:

- Kemi pasur 13 ri aplikime.
- Kemi përgatitur 50 vendime për të dy kategori
- Janë pranuar 14 deklarata të papunsisë.
- Janë pranuar 28 çertifikata të mjekut për komision mjekësor
- Janë procesuar 10 lëndë të reja në SNS-së
- Janë lëshuar 32 kartona të asistencës sociale
- Janë pranuar 7 ankesa për shqyrtim në shkallë të dytë
- 15 vërtetima që nuk janë shfrytëzues të ndihmes sociale
- 01 Lëndë në Gjykatë për shqyrtim
- 08 Konfirmim i Llogarisë Bankare

SHËRBIMI SOCIAL - Gjatë muajit Shkurt në zyrën e Shërbimit Social janë kryer këto shërbime:

14 Vërtetim për zotësi veprimi

09 Vërtetime për Heqjen e shtetësisë së Kosovës

01 Ftesa për seancë nga Gjykata për marrjen e zotësisë së veprimit.

04 Vizita në familjet të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përherëshme (FAKP)

01 Kontaktime të fëmijëve me prindërit të bashkëshortëve të shkurorëzuar

25 Lëndë janë regjistruar në Bazën e Shërbimeve Sociale.

05 Raporte për delikuent dërguar gjykates

03 kontaktime, ndërmjësime me QPS Ferizaj.

02 Vizita në teren për rregullimin e marrdhenjeve bashkshortore tek rastet e dhunes në familje. dhe raste tjera që janë në procedurë të shkurorëzimit.

05 Delikuent, QPS ja pjesmarrës në intervistim SHPK stacioni policor Kacanik dhe trajtimi i rastit.

Kemi pasur raste dhe këshillime profesionale të ndarjes së bashkëshortëve, të cilëve u janë marr deklarata dhe u janë dhënë këshilla profesionale për procedura të me tutjeshme .

Punë tjera të përditshme si organ këshilldhënës lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të gjitha kategoritë.

ASISTENCA SOCIALE - në zyrë të asistencës sociale janë kryer këto shërbime:

- Kemi pasur 34 ri aplikime.
- Kemi përgatitur 98 vendime për të dy kategori
- Janë pranuar 45 deklarata të papunsisë.
- Janë pranuar 37 çertifikata të mjekut për komision mjekësor
- Janë procesuar 18 lëndë të reja në SNS-së
- Janë lëshuar 54 kartona të asistencës sociale
- Janë pranuar 8 ankesa për shqyrtim në shkallë të dytë
- 17 vërtetime që nuk janë shfrytëzues të ndihmes sociale
- 06 Lëndë në Gjykatë për Shqyrtim
- 16 Konfirmim i Llogarisë Bankare

SHËRBIMI SOCIAL - Gjatë muajit Mars në zyrën e Shërbimit Social janë kryer këto shërbime:

08 Vërtetim për zotësi veprimi

08 Vërtetime për Heqjen e Shtetësisë së Kosovës

01 Ftesa për seancë nga Gjykata për marrjen e zotësisë së veprimit.

03 Vizita në familjet të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përherëshme (FAKP)

13 Kontaktime të fëmijëve me prindërit të bashkëshortëve të shkurorëzuar

38 Lëndë lëndë janë regjistruar në Bazën e Shërbimeve Sociale.

07 Raporte për delikuent dërguar Gjykates

05 Raporte të Hetimit Social nga Prokuroria Themelore Ferizaj

03 Kontaktime, ndërmjësime me QPS Ferizaj

06 Procesverbale për pranimin e atësisë dhe mëmësisë

03 Vizita në teren këshillime psiko sociale për disa nxënës që kanë braktisur shkollën

08 Vizita në teren për rregullimin e marrdhenjeve bashkëshortore tek rastet e dhunës në familje. dhe raste tjera që janë në procedurë të shkurorëzimit.

06 Delikuent, QPS ja pjesmarrës në intervistim në SHPK Stacioni Policor Kacanik dhe trajtimi i rastit.

01 Mendim për Besimin e fëmijëve dërguar Gjykatës

Kemi pasur raste dhe këshillime profesionale të ndarjes së bashkëshortëve, të cilëve u janë marr deklaratat dhe u janë dhënë këshilla profesionale per procedura te me tutjeshme .
Punë tjera të përditshme si organ këshilldhënës lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të gjitha kategoritë.

ASISTENCA SOCIALE - në zyret e asistencës sociale janë kryer këto shërbime:

- Kemi pasur 39 ri aplikime.
 - Kemi përgatitur 53 vendime për të dy kategori
 - Janë pranuar 41 deklarata të papunsisë.
 - Janë pranuar 38 certifikata të mjekut për komision mjekësor
 - Janë procesuar 16 lëndë të reja në SNS-së
 - Janë lëshuar 65 kartona të asistencës sociale
 - Janë pranuar 06 ankesa për shqyrtim në shkallë të dytë
- 08 vertetima që nuk janë shfrytëzues të ndihmes sociale
0 Lëndë në Gjykatë për Shqyrtim
07 Konfirmim i Llogarisë Bankare

SHËRBIMI SOCIAL - Gjatë muajit Prill në zyrën e Shërbimit Social janë kryer këto shërbime:

- 04 Vërtetime për Rregullimin e dokumentacionëve për fëmijë që kanë prindër të shkurorëzuar
02 Ftesa per seancë nga Gjykata per marrjen e zotesisë se veprimt
12 Vizita në familjet të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përherëshme (FAKP)
07 Kontaktime të fëmijëve me prindërit të bashkëshortëve të shkurorëzuar
28 Lëndë lëndë janë regjistruar në Bazën e Shërbimeve Sociale.
12 Raporte per delikuent derguar Gjykates
08 Raporte të Hetimit Social nga Prokuroria Themelore Ferizaj
02 Kontaktime, ndermjetsim me QPS Ferizaj
01 Procesverbale për pranimin e atësisë dhe mëmësisë
02 Vizita në teren këshillime psiko sociale për disa nxënës që kanë braktisur shkollën
05 Vizita ne teren për rregullimin e mardhënjeve bashkëshortore tek rastet e dhunës në familje. dhe raste tjera qe janë në procedurë të shkurorzimit.
08 Delikuent, QPS ja pjesmarres ne intervistim SHPK Stacioni Policor Kacanik dhe trajtimi i rastit.
01 Mendim për Besimin e fëmijëve dërguar Gjykatës
01 Kontratë e Strehimit Familjarë

Kemi pasur raste dhe këshillime profesionale të ndarjes së bashkëshortëve, të cilëve u janë marr deklaratat dhe u janë dhënë këshilla profesionale per procedura te me tutjeshme .
Punë tjera të përditshme si organ këshilldhënës lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të gjitha kategoritë.

ASISTENCA SOCIALE - në zyret e asistencës sociale janë kryer këto shërbime:

- Kemi pasur 20 ri aplikime.
- Kemi përgatitur 43 vendime për të dy kategori
- Janë pranuar 28 deklarata të papunsisë.
- Janë pranuar 26 certifikata të mjekut për komision mjekësor
- Janë procesuar 10 lëndë të reja në SNS-së
- Janë lëshuar 32 kartona të asistencës sociale
- Është pranuar 1 ankesë për shqyrtim në shkallë të dytë

- 8 vertetima që nuk janë shfrytëzues të ndihmes sociale
- 1 Lëndë në Gjykatë për Shqyrtim
- 5 Konfirmim i Llogarisë Bankare

SHËRBIMI SOCIAL - Gjatë muajit **Maj** në zyrën e Shërbimit Social janë kryer këto shërbime:

- 12 Vërtetim për zotësi veprimi
- 01 Vërtetim për Heqjen e Shtetësisë së Kosovës
- 04 Vërtetime për Rregullimin e dokumentacionëve për fëmijë që kanë prindër të shkurorëzuar
- 03 Ftesa për seancë nga Gjykata për marrjen e zotësisë së veprimit.
- 15 Vizita në familjet të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përherëshme (FAKP)
- 13 Kontaktime të fëmijëve me prindërit të bashkëshortëve të shkurorëzuar
- 45 Lëndë lëndë janë regjistruar në Bazën e Shërbimeve Sociale.
- 11 Raporte për delikuent dërguar Gjykatës
- 05 Raporte të Hetimit Social nga Prokuroria Themelore Ferizaj
- 02 Kontaktime, ndërmjetim me QPS Ferizaj
- 05 Anamneza Sociale
- 04 Vizita në teren këshillime psiko sociale për disa nxënës që kanë braktisur shkollën
- 05 Vizita në teren për rregullimin e marrëdhënjëve bashkëshortore tek rastet e dhunës në familje dhe raste tjera që janë në procedurë të shkurorëzimit.
- 11 Delikuent, QPS ja pjesëmarrës në intervistim SHPK Stacioni Policor Kacanik dhe trajtimi i rastit.
- 02 Mendim për Besimin e fëmijëve dërguar Gjykatës
- 03 Deklarata për çrregullime bashkëshortore
- 02 Përshtatshëri për adoptim
- 04 Raste të dhunës në familje
- 05 Aplikime për FAKP
- 06 Raste Komision Mjekësor

Kemi pasur raste dhe këshillime profesionale të ndarjes së bashkëshortëve, të cilëve u janë marrur deklaratat dhe u janë dhënë këshilla profesionale për procedurën me tutjeshme. Punë tjera të përditshme si organ këshilldhënës lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të gjitha kategoritë.

ASISTENCA SOCIALE - në zyret e asistencës sociale janë kryer këto shërbime:

- Kemi pasur 55 ri aplikime.
- Kemi përgatitur 86 vendime për të dy kategori
- Janë pranuar 58 deklaratat të papunsisë.
- Janë pranuar 09 certifikatat të mjekut për komision mjekësor
- Janë procesuar 20 lëndë të reja në SNS-së
- Janë lëshuar 63 kartona të asistencës sociale
- Janë pranuar 09 ankesa për shqyrtim në shkallë të dytë
- 18 vertetima që nuk janë shfrytëzues të ndihmes sociale
- 107 Lëndë të reja për Komision Mjekësor

SHËRBIMI SOCIAL - Gjatë muajit Qershor në zyrën e Shërbimit Social janë kryer këto shërbime:

- 11 Vërtetim për zotësi veprimi
- 01 Vërtetime për Heqjen e Shtetësisë së Kosovës
- 01 Vërtetim për Rregullimin e dokumentacioneve për fëmijë që kanë prindër të shkurorëzuar
- 02 Ftesa për seancë nga Gjykata për marrjen e zotësisë së veprimit.
- 15 Vizita në familjet të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përherëshme (FAKP)
- 06 Kontaktime të fëmijëve me prindërit të bashkëshortëve të shkurorëzuar
- 37 Lëndë lëndë janë regjistruar në Bazën e Shërbimeve Sociale.
- 04 Raporte për delikuent dërguar Gjykatës
- 02 Raporte të Hetimit Social nga Prokuroria Themelore Ferizaj
- 02 Kontaktime, ndërmjetim me QPS Ferizaj
- 01 Anamnezë Sociale
- 02 Vizita në teren këshillime psiko sociale për disa nxënës që kanë braktisur shkollën
- 09 Vizita në teren për rregullimin e marrëdhënjëve bashkëshortore tek rastet e dhunës në familje, dhe raste tjera që janë në procedurë të shkurorëzimit.
- 05 Delikuent, QPS ja pjesëmarrës në intervistim SHPK Stacioni Policor Kacanik dhe trajtimi i rastit.
- 02 Mendim për Besimin e fëmijëve dërguar Gjykatës
- 02 Deklarata për çrregullime bashkëshortore
- 04 Urdhërbrojtje njoftim nga Gjykata
- 01 Rast të dhunës në familje

Kemi pasur raste dhe këshillime profesionale të ndarjes së bashkëshortëve, të cilëve u janë marrur deklaratat dhe u janë dhënë këshilla profesionale për procedura të me tutjeshme .
Punë tjera të përditshme si organ këshilldhënës lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të gjitha kategoritë.

ASISTENCA SOCIALE - në zyret e asistencës sociale janë kryer këto shërbime:

- Kemi pasur 32 ri aplikime.
- Kemi përgatitur 27 vendime për të dy kategori
- Janë pranuar 26 deklaratat të papunësisë.
- Janë pranuar 15 certifikata të mjekut për komision mjekësor
- Janë procesuar 20 lëndë të reja në SNS-së
- Janë lëshuar 08 kartona të asistencës sociale
- Janë pranuar 04 ankesa për shqyrtim në shkallë të dytë
- 13 vërtetime që nuk janë shfrytëzues të ndihmës sociale

Drejtoria e Arsimit

Projekti "Ndërtimi i sallës së edukates fizike në ShFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec është në fazën përfundimtare. Ky projekt ka filluar në vitin 2023 dhe sipas planifikimit përfundon këtë vit. Punët janë përcjellë në çdo hap nga menaxheri i projektit dhe bazuar në raportet e tij, operatori ka përfill me përpikmëri dinamikën e kryerjes së punëve dhe planin detal.

Ka përfunduar faza e tenderimit të projektit "Rregullimi i kulmit të ShFMU "Agim Bajrami" në Stagovë dhe menjëher pas nënshkrimit të kontratës kanë filluar punimet.

Është në fazën përfundimtare të tenderimit projekti "Izolimi I jashtëm dhe zbatimi I masave të efijencës në ShFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj.

Projekti "Ndërtimi i aneksit të IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"" është projekt dyvjeçar i cili është punuar si projekt detal nga kompania e kontraktuar për hartim të projekteve. Pas finalizimit të projektit në prill të vitit 2024, është publikuar tenderi dhe është në fazën e vlerësimit.

Projekti "Ndërtimi i sallës së edukates fizike në ShFMU "Idriz Seferi" në Bob, është finalizuar si projekt detal nga kompania e kontraktuar për hartim të projekteve. Sipas planifikimit është projekt dyvjeçar I financuar nga buxheti i komunës dhe është në proces të tenderimit.

Në bashkëpunim me MASHTI-n dhe kompaninë e kontraktuar për dizajnim të shkollave, është bërë përzgjedhja e projektit për objektin e ShFMU "Emin Duraku" në Kaçanik dhe në afate rekorde jemi përgjigjur të gjitha kërkesave që janë adresuar në komunë. Mbetet në vullnetin e MASHTI-t për të vazhduar me procedura tjera.

Projekti i çerdhes për fëmijë në Kaçanik të Vjetër do të financohet nga Bashkimi Evropian prandaj është prolonguar për vitin e ardhshëm për shkak të masave të vendosura për Kosovën, ndërsa për ndërtimin e çerdhes për fëmijë në Rekë janë kryer të gjitha procedurat që i takojnë komunës deri sa është lëshuar edhe Leja e ndërtimit, por mbetet në vullnetin e MASHTI-t për të vazhduar me procedurat e ndërtimit.

Nga subvencionet në arsim, janë ndarë bursat për 41 studentë (500 euro për student) dhe është paguar pjesa e pare prej 250 euro, është kryer transporti dhe përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe janë mbajtur trajnime për 120 mësime në tri programe të ndryshme.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar - Qershor 2024

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar - Qershor 2024 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë. Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesëve do të prezantohet për gjitha programet buxhetore:

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2024

TABELA 1: IMPLEMENTIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2024

TË HYRAT BUXHETORE		Buxheti i miratuar 2024	Buxheti i tanishëm 2024	Shpenzimet 31.06-2024	Shpenzimet 31.06-2023	Progresi në %	Krahasimi 2024/23 në €	Indeksi 2024/2023 (%)
		1	2	3	4	5=3/2	6=3-4	7=3/4
A	TOTAL FINANCIMI QEVERITAR	11,034,783.00	11,034,783.00	4,415,999.06	4,050,376.65	40.02	365,622.41	9.03
1	GRANTI I PËRGJITHSHËM	5,130,643.00	5,130,643.00	1,463,362.36	1,310,428.64	28.52	152,933.72	11.67
2	GRANTI I ARSIMIT	4,395,331.00	4,395,331.00	2,326,365.08	2,107,916.68	52.93	218,448.40	10.36
3	GRANTI I SHËNDETËSISË	1,508,809.00	1,508,809.00	626,271.62	632,031.33	41.51	(5,759.71)	(0.91)
B	TOTAL TE HYRAT VETANAKE-PARTICIPIMET DHE DONACIONET	924,200.00	1,792,057.42	98,501.70	-	5.50	98,501.70	#DIV/0!
4	TË HYRAT VETANAKE 2024	924,200.00	924,200.00	1,007.70	-	0.11	1,007.70	#DIV/0!
5	TË HYRAT E BARTURA NGA VITI PARAPRAK	-	867,857.42	97,494.00	-	-	97,494.00	-
6	BARTJET E FONDEVE TË VITIT PARAPRAK: DONATORËT, PARTICIPIMET	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI (A+B)		11,958,983.00	12,826,840.42	4,514,500.76	4,050,376.65	35.20	464,124.11	11.46

-Buxheti i miratuar i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2024, është caktuar sipas Qarkores Buxhetore nr.2024/01 me kufijtë buxhetor fillestar në shumë prej: **11,958,983.00€**.

-Mjetet pjesërisht të bartura nga vitet paraprake të cilat i janë shtuar buxhetit aktual janë në shumë prej 867,857.42 euro. Kështu shuma e buxhetit të tanishëm ka arritur në **12,826,840.42** euro.

- Burimet e financimit të Buxhetit Komunal vijnë nga:

1. Granti i përgjithshëm	5,130,643.00 €
2. Granti specifik i arsimit:	4,395,331.00 €
3. Granti specifik për shëndetësi:	1,508,809.00 € dhe
4. Të hyrat vetanake:	924,200.00 €

Struktura e përbërjes së buxhetit sipas burimeve të financimit duket kështu:

Grantet Qeveritare: 11,034,783.00 € apo 92.27 % e buxhetit total,
HVK – ProjekSIONET : 924,200.00 € apo 7.73 % e buxhetit total.

-Shpenzimi total per periudhen Janar – Qershorë 2024 është në shumë prej 4,514,500.76€ apo 35.20% e planifikimit vjetorë 2024.

II. Raporti i inkasimit të të hyrave vetanake:

Të hyrat vetanake direkte të grumbulluara gjatë periudhës raportuese kanë arritur lartësinë e realizimit prej 351,713.65€ që përbëjnë 38.06% të planifikimit të gjithëmbarshtëm vjetorë në shumë prej 924,200.00€. Këto të hyra për periudhën Janar-Qershor 2024 janë krijuar sipas burimeve të identifikuar nga të gjitha Drejtoritë bazuar në planifikimet vjetore.

- Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave janë grumbulluar gjithsej: 193,450.36€ apo 55% e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrit janë grumbulluar gjithsej mjete në shumë prej: 82,337.91€ apo 23.41% e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Shuma tjetër e grumbullimit të mjeteve, është realizuar nga këto pesë (6) programe apo drejtori: Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shuma prej: 9,689.82€, Administratës së Përgjithshme, shuma prej: 9,873.00€, Arsimi 23,814.00€, Drejtoria e Bujqësisë, Plltarisë dhe Zhvillimit Rural, shuma prej: 15,266.86€, Drejtoria e Shërbimeve Publike, shuma prej: 11,951.70€ dhe Zyra e Inspektoriatit shuma prej 5,330.00€ që së bashku përbëjnë 21.59% e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Krahasuar me inkasimin e realizuar të vitit 2023 të së njejtës periudhë, nga raporti i realizimit të HVK-së të vitit 2024 del se janë inkasuar mjete prej: 171,486.67.00 € më pak se në vitin 2023 nga të hyrat direkte.
- Rënia në grumbullimin e të hyrave vetanake në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, fillimisht ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në Ligjin e Tatimit në pronë, ku sipas ligjit të ri është rritur vlera e zbritjes për secilin tatimpagues për pronën e cilësuar për banim primarë nga 15,000.00€ në 30,000.00€, ndryshimet tjera sipas UA nga Qeveria siq është heqja e kushtëzimeve administrative me rastin e regjistrimit të veturave, ndryshimeve tjera kadastrale si psh.shitë-blerja e pronave private nga tatimpaguesve borgjlinjë në tatim prone, poashtu edhe rënia nga taksat për leje ndërtimore të Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinorë dhe Mjedisit.

Të hyrat indirekte të cilat realizohen nga Gjykatat, Policia dhe Agjensioni Pyjor i Kosovës nuk na janë dërguar ende. Keto te hyra meqë realizohen nga keto institucione tjera, nuk përfshihen në planifikim por vetëm si realizim sepse edhe shpenzimi i tyre i takon komunave.

- Ndërsa tabela në vijim paraqet në mënyrë të përgjithshme realizimin e hvk-së për periudhën raportuese, krahasimin e realizimit mes drejtorive dhe viteve:

Emertimi i të hyrave vetanake	Planifikimi Janar-Dhjetor 2024	Realizimi: Janar-Qershor 2024	Plani/Realizimi vjetorë (në %)	Realizimi: Janar-Qershor 2023	Krahasimi 2024/2023
Tatimi në pronë	391,545.00	132,009.30	33.71	218,066.81	(86,057.51)
Tatimi në tokë	80,543.00	24,647.06	30.60	57,681.01	(33,033.95)
Taksa nga rëxhistrimi i automjeteve	70,000.00	35,270.00	50.39	31,395.00	3,875.00
Taksa nga ushtrimi i veprimtarisë	3,000.00	-	-	2,380.00	(2,380.00)
Taksa tjera	1,000.00	1,524.00	152.40	211.10	1,312.90
Total: Buxhet dhe Financa	546,088.00	193,450.36	35.42	309,733.92	(116,283.56)
Taksa komunale për leje ndërtimi	190,000.00	20,000.55	10.53	105,350.44	(85,349.89)
Taksa për regjistrimin e trashigimisë	2,000.00	-	-	848.92	(848.92)
Taksa tjera Administrative	1,000.00	29,562.29	2,956.23	24,458.00	5,104.29
Taksa për çerifikata të pronësisë dhe kopje planim	15,000.00	4,233.00	28.22	5,266.00	
Taksa për leje mjedisore	12,000.00	1,620.90	13.51	10,403.92	
Taksa për legalizimin e objekteve	10,000.00	7,595.77	-	5,618.46	
Shfrytëzimi i pronës publike	16,812.00	11,186.40	66.54	3,653.46	7,532.94
Taksa për matjen e tokës në teren	7,000.00	8,139.00	116.27	5,388.00	2,751.00
Total: Urbanizmi & Kadastrë	253,812.00	82,337.91	32.44	160,987.20	(70,810.58)
Shfrytëzimi publik për tregti të hapur (reklamati)	1,600.00	1,471.20	91.95	2,432.60	(961.40)
Taksa për parking publik	10,000.00	10,480.50	104.81	-	
Taksa tjera Administrative	100.00	-	-	177.50	(177.50)
Total: Shërbimet Publike dhe Emergjencia	11,700.00	11,951.70	102.15	2,610.10	(1,138.90)
Taksa e Ndërrimit Destinit të Tokës	20,000.00	13,750.89	68.75	11,079.50	2,671.39
Taksa për Shfrytëz. e Resurseve nat.	2,000.00	-	-	1,165.10	(1,165.10)
Taksa tjera	2,000.00	1,515.97	75.80	620.00	895.97
Total: Bujqësia dhe Pyltaria	24,000.00	15,266.86	63.61	12,864.60	2,402.26
Taksa e çertifikatave të lindjes	15,000.00	7,975.00	53.17	732.00	7,243.00
Taksa e çertifikatave të kurorëzimit	5,000.00	1,046.00	20.92	1,063.00	(17.00)
Taksa e çertifikatave të vdekjes	1,000.00	227.00	22.70	182.00	45.00
Taksa e çertifikatave tjera ofiçare	5,000.00	-	-	8,596.00	(8,596.00)
Taksa tjera Administrative	1,000.00	625.00	62.50	61.00	564.00
Total: Administrata e Përgjithëshme	27,000.00	9,873.00	36.57	10,634.00	(761.00)
Gjobat nga inspektorati	5,000.00	5,330.00	106.60	2,765.00	2,565.00
Inspektimi higjieniko-sanitarë	200.00	-	-	-	-
Inspektimi i respektimit të planit Urb.	200.00	-	-	-	-
Licencat pranim tekn.lokalit	200.00	-	-	-	-
Total: Të hyrat nga Inspektorati	5,600.00	5,330.00		2,765.00	2,565.00
Taksa për çertifikata mjekësore	10,000.00	4,755.00	47.55	4,986.00	(231.00)
Participimet në shëndetësi	10,000.00	4,934.82	49.35	10.00	4,924.82
Total: Shëndetësia dhe M.S.	20,000.00	9,689.82	48.45	4,996.00	4,693.82
Participimet	36,000.00	23,814.00	66.15	18,609.50	5,204.50
Total: Arsimi dhe Kultura	36,000.00	23,814.00	66.15	18,609.50	5,204.50
GJITHSEJ TË HYRAT DIREKTE	924,200.00	351,713.65	38.06	523,200.32	(171,486.67)

III . Shpenzimet e realizuara për periudhën Janar - Qershor 2024:

Dinamika e shpenzimeve për këtë periudhë është realizuar me **35.22 %** në raport me Buxhetin aktual apo shuma prej **4,514,500.76€** ndërsa krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shkallën e shpenzimit prej **11.46%** më shumë apo shumën prej: **464,124.11€**.

KATEGORITE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE (KESH)	Buxheti aktual 2024	Shpenzimet e realizuara 31.06-2024	Shpenzimet e realizuara 31.06-2023	Progresi përball plan. buxhetor	Krahasimi: Buxheti - Shpenzimet	Krahasimi 2024 / 2023 në €	Krahasimi 2024/2023 në %
	1	2	3	4=2/1	5=1-2	6=2-3	7=2/3
1 Pagat dhe medijtjet	6,749,178.84	3,327,945.37	3,016,222.88	49.31	3,421,233.47	311,722.49	10.33
2 Mallrat dhe shërbimet	1,430,806.00	461,858.35	383,459.21	32.28	968,947.65	78,399.14	20.45
3 Shpenzimet komunale	252,245.64	84,277.12	44,850.70	33.41	167,968.52	39,426.42	87.91
4 Subvencionet dhe transferet	465,331.00	133,948.00	114,479.80	28.79	331,383.00	19,468.20	17.01
5 Shpenzimet kapitale	3,894,277.21	506,471.92	491,364.06	13.01	3,387,805.29	15,107.86	3.07
6 Rezerva komunale	25,000.00	-	-	-	25,000.00	-	#DIV/0!
TOTALI (1 deri 6)	12,816,838.69	4,514,500.76	4,050,376.65	35.22	8,302,337.93	464,124.11	11.46

Tabela e planifikimit të ndarjeve buxhetore sipas Drejtorive apo Programeve Buxhetore për vitin 2024

SEKTORI - DREJTORIA:	PAGA DHE MEDITJE	MALLRA DHE SHERBIME	SHPENZIME KOMUNALE	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	INVESTIME KAPITALE	TOTALI
ZYRA E KRYETARIT	247,733.53	20,000.00	-	60,000.00	-	327,733.53
ADMINISTRATA E PERGJITHSHME & Q.Gjinore	154,956.21	85,000.00	15,000.00	-	412,000.00	666,956.21
KUVENDI KOMUNAL	221,755.26	5,000.00	-	-	-	226,755.26
ZHVILLIMI EKONOMIK	23,954.42	5,000.00	-	40,000.00	335,000.00	403,954.42
BUXHETIMI - FINANCAT	80,601.27	10,000.00	-	-	250,000.00	340,601.27
SH.PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMERGJENCA	245,600.91	310,000.00	80,000.00	60,000.00	496,313.00	1,191,913.91
ZYRA E KOMUNITETEVE	10,439.86	1,000.00	-	-	-	11,439.86
BUJQESIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL	104,111.60	10,000.00	-	100,000.00	50,000.00	264,111.60
URBANIZMI - PLANIFIKIMI URBAN	116,206.76	65,000.00	-	-	1,012,279.00	1,193,485.76
AD.SHËND. DHE SHERBIMET SOCIALE	88,225.95	5,000.00	5,000.00	10,000.00	5,000.00	113,225.95
SHERBIMET SHENDETESORE PRIMARE	1,138,296.07	290,513.00	50,000.00	-	50,000.00	1,528,809.07
KULTURA, RINIA, SPORTET	131,628.93	130,000.00	15,000.00	70,000.00	135,000.00	481,628.93
ARSIMI DHE SHKENCA	4,208,367.24	385,000.00	50,000.00	50,000.00	515,000.00	5,208,367.24
TOTAL BUXHETI:	6,771,878.00	1,321,513.00	215,000.00	390,000.00	3,260,592.00	11,958,983.00

Tabela në vijim paraqet shpenzimin sipas Programeve Buxhetore dhe atë sipas K.Ekonomike Janar-Qershor 2024

NR	PROGRAMET BUXHETORE (11)	Stafi i lejuar	Pagat dhe mëditje	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Totali	Struktura në % sipas (PB)
1	Zyra e kryetarit	27	122,729.82	22,504.41	-	25,700.00		170,934.23	3.79
2	Administrata e pergjithshme	25	79,558.72	40,917.44	10,106.08			130,582.24	2.89
3	Zyra e kuvendit komunal	23	111,858.48	550.80				112,409.28	2.49
4	Financat, Buxheti	11	33,149.47	-				33,149.47	0.73
5	Zhvillimi Ekonomik, Turizmi	3	10,858.74	456.90			91,634.25	102,949.89	
6	Shërbimet publike dhe emergjenca	28	149,889.88	221,732.42	38,380.16	14,175.00	197,713.87	621,891.33	13.78
7	ZLK	1	5,445.39	-				5,445.39	-
8	Bujqësia, Pylltaria dhe ZHR	15	22,065.55	1,539.91				23,605.46	0.52
9	Kultura, Rinia dhe Sportet	18	56,230.54	27,683.29	9,283.21	58,450.00	33,524.12	185,171.16	
10	Planifikim urban dhe mjedisi	13	50,599.41	10,688.36			114,437.84	175,725.61	3.89
	ADMINISTRATA KOMUNALE	164	642,386.00	326,074	57,769	98,325	437,310	1,273,743.01	28.21
11	Shëndetësia dhe mirëqenia soc.	130	542,963.86	67,299.01	10,195.11	1,500.00	4,313.64	626,271.62	13.87
12	Arsimi	535	2,142,595.51	68,485.81	16,312.56	34,123.00	64,848.20	2,326,365.08	51.53
	TOTALI (1 deri 11)	829	3,327,945.37	461,858.35	84,277.12	133,948.00	506,471.92	4,514,500.76	100.00
	Struktura ne % sipas (KESH)		73.72	10.23	1.87	2.97	11.22	100.00	

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE NË MALLËRA DHE SHËRBIME													Sipas gjendjes më 30.06.2024			
KESH	MALLËRAT DHE SHËRBIMET	Zyra e Kryetarit	Zyra e Kuvendit	Zhvillimi Ekonomik	Administrata e Përgjithshme	Financat	Sherbimet Publike	Bujqësia, Pylltaria e ZHR	Urbanizmi dhe Kadastrë	Kultura	Arsimi	Shëndetësi dhe MS	Totali TM2/2024	Struktura në %	TM2 2023	Dallimi ne EURO
13140	UDHËTIMET ZYRTARE JASHT VENDIT	7,350											7,350	2	171	7,179
13310	SHPENZIMET E INTERNETIT								50				50	0	460	(410)
13360	SHPENZIMET E TELEFONISË MOBILE				2,735								2,735	1	2,305	-
13330	SHPENZIMET POSTARE				25								25	0	4,029	(4,004)
13430	SHËRBIMET E NDRYSHME SHËNDETËSORE											2,791	2,791	1	1,430	-
13440	SHËRBIMET KËSHILLDHËNËSE DHE PROFESIONALE	1,383			8,467					1,900			11,750	3	1,970	9,780
13445	SHËRBIMET-KONSULENT DHE KONTRAKTOR INDIVIDUAL											7,000	7,000			
13470	SHPENZIMET E SHËRBIMEVE TEKNIKE	3,900		70			100			1,000	990		5,990	1	5,731	259
13460	SHPENZIMET E SHËRBIMEVE KONTRAKTUESE								457		21,276		21,732	5	85,986	(64,254)
13475	SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE				8,766					14,026	2,192	10,958	35,942		-	35,942
13480	SHPENZIMET PËR ANËTARSIM	5,011											5,011	1	4,000	1,011
13501	MOBILIJE (më pak se 1000 euro)											3,460	3,460	1	-	3,460
13556	SHPENZIMET E PAISJES SPECIALE MJEKËSORE												-	-	3,776	(3,776)
13610	SHPENZIMET E FURNIZIMIT PËR ZYRË	1,085			1,896		166		1,063	1,120	2,175		7,504	2	9,381	(1,877)
13620	SHPENZIMET E FURNIZIMIT ME USHQIM E PIJE		90		1,164					16	8,373	455	10,099	2	9,627	472
13630	SHPENZIMET E FURNIZIMEVE MJEKËSORE											21,283	21,283	5	9,336	11,947
13640	FURNIZIMET E PASTRIMIT				200		102			1,753	5,397		7,451	2	1,660	5,791
13720	SHPENZIMET E NAFTËS PËR NGROHJE									6,561			6,561	1	-	6,561
13760	DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE				319						24,946		25,265	5	26,598	(1,333)
13780	DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATOR, MAKINERI				6,188		1,712	1,080		130	600	7,925	17,635	4	23,790	(6,155)
13810	Paraja e imët (Pety Cash)												-		500	(500)
13950	REGJISTRIMI & SIGURIMI I AUTOMJETEVE	374								940	303	338	1,956	0	2,081	(125)
14010	MIRËMBAJTJA E RIPARIMI I AUTOMJETEVE	105			1,788		778	419		142		2,336	5,568	1	8,906	(3,338)
14020	MIRËMBAJTJA E RIPARIMI I NDËRTESAVE											1,229	1,229	0	10,755	(9,526)
14023	MIRËMBAJTJA E SHKOLLAVE										2,006		2,006	0	2,740	(734)
14032	MIRËMBAJTJA E RRUQËVE LOKALE						179,798						179,798	39	148,667	31,131
14060	MIRËMBAJTJA RUTINORE						23,083		9,497				32,580		2,659	29,921
14050	MIRËMBAJTJA E MOBILJEVE DHE PAISJES											6,824	6,824	1	8,398	(1,574)
14130	QERAJA PËR PAISJE-MIRËMBAJTJA E TI				238						89		327		1,971	(1,644)
14310	SHPENZIMET E PËRFAQESIMIT BRENDA VENDIT	2,157	461	387	1,740			41	78	95	141		4,713	1	681	4,032
14410	SHPENZIMET E VENDIMEVE TË GJYKATAVI	1,139			7,390		15,994					2,700	27,223	6	5,321	21,902
	TOTALI I SHPENZIMEVE :	22,504	551	457	40,917	-	221,732	1,540	11,145	27,683	68,486	67,299	461,858	100	383,460	78,398
	Struktura e pjesëmarrjes	4.87	0.12	0.10	8.86	-	48.01	0.33	2.41	5.99	14.83	14.57	100			

SHPALOSJA E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE:

KODI 13440 - SHERBIMET KESHILLDHËNËSE DHE PROFESIONALE: Këtu bëjnë pjesë pagesat ndaj Administratoreve të fshatrave në shumë prej 8,467.20 euro të kompensuara nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, shuma prej 1,383.00 euro nga Zyra e Kryetarit për kompensimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit, anëtarëve të KKSb-ës dhe shuma prej 1,900.00 euro nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për kompensimin e anëtarëve të komisioneve të themeluara për vlerësim të aplikacioneve për financim të OJQ-ve të ndryshme.

KODI 13475 - SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE: Deri në vitin 2023 shpenzimet për sigurimin fizik të objekteve kanë qenë të përfshira në kodin 13460 të shërbimeve kontraktuese tjera. Ndersa nga viti 2024 Thesari-MFPT ka specifikuar në planin e ri kontabël kodin e veçantë për sigurimin fizik të objekteve.

KODI 13760 - DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE: Në planin e ri kontabël të hartuar nga Thesari-MFPT, këtu përfshihen: drutë, peleti, etj furnizime nga druri për nxemje.

KODI 14410 - SHPENZIMET E VENDIMEVE TË GJYKATAVE: Për Sulahe Luzha-lende permbarimore shuma 7,390.02 euro kompensim per parcela - Administrata e Pergjithshme. Për Qefsere Koraqi-lende permbarimore-padi per shpronësim prone me rastin e ndertimit te trotuarit përgjatë rrugës Bob-Doganaj, shuma prej 3,672.34 euro dhe per Grand Construction Shpk-ZP Shala Shpk-lende permbarimore-padi për kompensim te situacionit përfundimtar të pagesës te kontrata vjetore per mirembajtje te rrugëve te vitit 2020, shuma prej 12,321.57 euro - Sherbimet Publike. Aliu Law Shpk - lende permbarimore te Shëndetësia shuma prej 2,699.62 euro.

KODI 14032 - MIRËMBAJTJA E RRUGËVE LOKALE: Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve lokale për kontratën e vitit 2024 ne shumë prej 99,927.16 euro, shuma prej 38,161.04 euro pagesat e obligimeve të kontratës se vitit 2023 si, shuma prej 25,039.82 euro kompensimi i inflacionit ndaj operatoreve ekonomik konform Ligjit per Punet Publike , mirembajtja e ndriqimit publik ne shumë prej 6,799.50 euro, rregullimi dhe mirembajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët lokale të komunës shuma prej 9,870.50 euro.

KODI 14060 - MIREMBAJTJA RUTINORE: Te Drejtoria e Shërbimeve Publike jane kryer pagesat për obligimet e vitit te kaluar ne shumë prej 2,389.60 euro për mirembajtjen e hapsirave publike te xhelbruara sipas marrëveshjes me KRM Pastertia dhe për pagesen e obligimeve te vitit te kaluar per kontratën dekorimi I qytetit për festat e fund vitit, ndërsa shuma prej 18,912.90 euro jane pagesa e situacioneve per mirembajtjen e hapsirave xhelbruese per periudhen janar-qershor 2024 sipas marrëveshjes me KRM Pastertia per vitin 2024.

KODI 13445 - SHËRBIMET-KONSULENT DHE KONTRAKTOR INDIVIDUAL: Pagesa nga Drejtoria e Shëndetësisë ndaj mjekëve specialist të angazhuar ne QKMF, shuma 7,000.00 euro.

SHPENZIMET KOMUNALE									
KODI	PERSHKRIMI	ADMINISTRATA E PERGJITHSHE	SHËNDETËSIA DHE MS	SHËRBIMET PUBLIKE	KULTURA, RINIA DHE SPORTI	ARSIMI	TOTALI TM2 2024	TOTALI TM2 2023	KRAHASIMI NE %
13210	SHPENZIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE	5,017.35	8,473.18	38,257.26	7,571.79	8,974.64	68,294.22	34,377.29	98.66
13220	SHPENZIMET E UJIT	1,186.09	67.57	55.17	675.54	2,930.14	4,914.51	2,861.57	71.74
13230	SHPENZIMET E MBETURINAVE	3,337.88	1,345.68	-	1,035.88	3,386.79	9,106.23	5,805.24	56.86
13250	SHPENZIMET E TELEFONISË FIKSE	564.84	308.68	67.73	-	1,020.99	1,962.24	1,806.60	8.62
	TOTALI	10,106.16	10,195.11	38,380.16	9,283.21	16,312.56	84,277.20	44,850.70	87.91
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET									
KODI	PERSHKRIMI	ZYRA E KRYETARIT	SHËNDETËSIA DHE MS	SHËRBIMET PUBLIKE	KULTURA, RINIA DHE SPORTI	ARSIMI	TOTALI TM2 2024	TOTALI TM2 2023	KRAHASIMI NE %
21110	SUBVENCIONE PËR ENTITETE PUBLIKE		-	14,175.00		-	14,175.00	18,200.00	(22.12)
21200	SUBVENCIONE PËR ENTITETE JOPUBLIKE		-		58,450.00	19,093.00	77,543.00	45,356.00	70.97
22200	PAGESA PËR PËRFITUES INDIVIDUAL	25,700.00	1,500.00		-	15,030.00	42,230.00	49,273.80	(14.30)
	TOTALI	25,700.00	1,500.00	14,175.00	58,450.00	34,123.00	133,948.00	112,829.80	18.72

Subvencionet dhe Transferet - ndarja në detaje

Nr. Rend.	Përshkrimi	Shpenzmet Janar - Qershor 2024
I.	ZYRA E KRYETARIT	25,700.00
1	PAGESA PER PERFITUES INDIVIDUAL-NDIHMA QASTI	10,700.00
2	OVL E UÇK - SË	12,000.00
3	Qendra per mbrojtjen e grave dhe femijeve "Shtëpia ime"	3,000.00
II.	DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE	14,175.00
1	BIK-KAÇANIK (pagesat për rastet mortore)	14,175.00
III.	PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK	-
1		-
IV.	DREJTORIA E BUJQËSISË & PYLLTARISË	-
1	Pagesa per projektin subvencionimi me koshere bletësh dhe makina centrifugë	-
2	Pagesat per mbeshtetjen e fermerëve me makin mjelese	-
V.	DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE M.SOCIALE	1,500.00
1	PAGESA PER PERFITUES INDIVIDUAL	1,500.00
VI.	DREJTORIA E ARSIMIT	34,123.00
1	TRANSPORTI I NXENESEVE PER KATEGORITË E NDRYSHME	23,873.00
2	PAGESA E BURSAVE PER STUDENTE (250 euro per student-pjesa e parë)	10,250.00
VII.	DREJTORIA E KULTURES, RINISË DHE SPORTEVE	58,450.00
1	KF LEPENCI	10,000.00
2	FONDACIONI BONEVET KAÇANIK	1,400.00
3	KB KAÇANIKU MESHKUJT	2,750.00
4	KFFBBK	2,000.00
5	KLUBI BASKETBOLLISTIK LEPENCI	1,800.00
6	KLUBI MUNDJES KAÇANIKU	2,000.00
7	KLUBI I VOLEJBOLLIT KAÇANIKU	2,900.00
8	KLUBI TAEKWONDO KAÇANIKU 2000	1,750.00
9	KSH LEPENCI	2,500.00
10	KVK FEMRAT	2,000.00
11	KVRL KAÇANIK	2,000.00
12	MOTOKROSS KAÇANIKU	2,500.00
13	OKPIP KAÇANIK	1,000.00
14	NGO CAMP OF MURAL ARTISTS	2,150.00
15	QK KAÇANIKU	9,000.00
16	SHOQATA KULLA E GURIT	1,500.00
17	SHBA KAÇANIKU 2015	1,500.00
18	SHKA TINGUJT E VENDLINDJES	3,500.00
19	SHOQ.KULTURORE ARTISTIKE GRYKA E KAÇANIKUT	2,000.00
20	SHOQATA E PESHK. SPOR. REKREA. "TROFTA E LEPENCIT"	1,000.00
21	SHPKFSSHK KAÇANIK	3,200.00
Totali (I+II+III+IV) :		133,948.00

SUBVENCIONET DHE TRANSFERET
SHPENZIMI PER PERIUDHEN: JANAR-QERSHOR 2024

Prog.	Përshkrimi	Planifikimi-Buxheti 2024
1	2	3
16028	Zyra e Kryetarit	70,529
18028	Drejtoria e Sherbimeve Publike	60,000
48028	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	40,000
47028	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zh.R	100,000
73037	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mbrojtja Sociale (MS)	10,000
85028	Kultura, Rinia dhe Sporti	85,000
92140	Arsimi dhe Kultura	50,000
Totali:		415,529.00

LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE JANAR QERSHOR 2024

PERSHKRIMI I PROJEKTTIT	PLANIFIKIMI	SHPENZIMI	MJETE TE LIRA	REALIZIMI NE
				%
DREJTORIA ADMINISTRATA E PERGJITHSHME	365,000.00	0.00	365,000.00	0.00
BLERJA E VETURAVE PËR NEVOJA TË ADMINISTRATËS KOMUNALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDËRTIMI I ANEKSTIT TË OBJEKTIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDERTIMI I PARKINGUT NENTOKËSORË PËR ADMINISTRATËS KOMUNALE	345,000.00	0.00	345,000.00	0.00
RREGULLIMI I SISTEMIT TE NGROHJES QENDRORE TE OBJEKTIT TË ADMINISTRATËS	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA	230,871.60	0.00	230,871.60	0.00
MJETET PER BASHKFINANCIM TE PROJEKTEVE	230,871.60	0.00	230,871.60	0.00
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE-INFRASTRUKTURA RRUGORE	755,579.01	197,713.87	557,865.14	26.17
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës së fshatrave Llanishtë - Nikoc	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
RREG.I RRUGES BOB-KULLA HASANIT	105,000.00	30,000.00	75,000.00	28.57
RREGULLIMI I TROTUARIT NE RRUGEN BOB-DOGANAJ	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NDËRKOMUNALE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDERTIMI I IMPIANTIT PER TRAJTIMIN E UJRAVE TË ZEZA	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
NDERTIMI I OBJEKTIT PER ZJARREFIKESIT - KAÇANIK	40,039.41	20,000.00	20,039.41	49.95
ASFALTIMI I RRUGES QË LIDHË FSHATRAT KOTLINË-IVAJË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDËRTIMI I STAZËS PËR KËMBËSOR DHE SHTEGUT PËR BICIKLISTA PË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
RREGULLIMI I SHESHIT TE QYTETIT - FAZA I-RË	43,313.00	16,485.88	26,827.12	38.06
NDERTIMI I KOLEKTORIT KRYESORË PER TRAJTIMIN E UJRAVE TE ZEZA	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
ND,ASF RRUGËS ISMAIL RAKA,PREJ SHT.SË KUL.DERI XHAMIA DËSHMOREVE	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS IDRIZ SEFERI	105,000.00	0.00	105,000.00	0.00
VENDOSJA TABELAVE DIGJITALE ME MBISH.-MIRËSEVINI NË KAÇANIK	2,200.45	0.00	2,200.45	0.00
REHABILITIMI I DY SHETITOREVE PËRGJATË LUMIT NERODIME	12,453.60	0.00	12,453.60	0.00
RREGULLIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË FSHATIN BEGRACE	11,363.12	9,850.93	1,512.19	86.69
NDËRTIMI I FABRIKËS PËR TRAJTIMIN E UJIT TË PIJES NË SEPETIN	12,626.00	0.00	12,626.00	0.00
NDERTIMI I TROTUARIT NE RRUGEN REGIONALE AHMET KAÇIKU	75,000.00	0.00	75,000.00	0.00
RREGULLIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NË RRUGËN HETEM HASAJ-GABRRIC	51,022.18	22,347.35	28,674.83	43.80
ASFALTIMI I RRUGES KAÇANIK I VJETER - BEGRACE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
NDERTIMI I KANALIZIMEVE FEKALE DHE ATMOSFERIKE NE LOKALITETE	137,392.84	67,393.83	69,999.01	49.05
NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I RRJETEVE TË UJËSJELLËSVE NË LOKALI	75,168.41	31,635.88	43,532.53	42.09
ASFALTIMI I RRUGËS "HAMËZ JASHARI" SEGMENTI SILKAPOR - RAKAJ	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00

BUJQËSIA - KAÇANIK	52,000.00	0.00	52,000.00	0.00
NDËRTIMI I KANALEVE TË UJITJES NË FSHATRRAT BIQEC, KOVAQEC DHE NIKAJ	52,000.00	0.00	52,000.00	0.00
PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - KAÇANIK	330,009.06	91,634.25	238,374.81	27.77
ND.TROT.SHTEGUT PERÇIKLIZËM,NDR.PUB NE RR.MURAT LIKA SHTRAZË	85,009.03	26,860.97	58,148.06	31.60
NDERTIMI I SHKALLEVE TE GURI SHPUAR	150,000.03	34,139.00	115,861.03	22.76
NDERTIMI I PARKUT REKREATIV NE ZONEN TURISTIKE SHTRAZË	55,000.00	30,634.28	24,365.72	55.70
NDERTIMI I SHTEGUT TË LIRISË	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
DREJTORIA E URBANIZMIT, PLANIFIKIMIT DHE MJEDISIT	1,076,146.88	114,437.84	961,709.04	10.63
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI RR.GËRLICË-K.VJETËR-STAGOVË-RUNJEVË	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
NDERTIMI DHE RREGULLIMI I QARSHISE SE VJETER TE QYTETIT	29,771.10	0.00	29,771.10	0.00
NDËRTIMI I SHTRËTËRVE TË LUMENJËVE DHE PËRROCKAVE NË LAGJEN	180,659.17	29,825.74	150,833.43	16.51
NDERTIMI I URES MBI LUMIN NERODIME DHE MBI HEKURUDHË	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJSËN URBANE-KAÇANIK	30,328.67	0.00	30,328.67	0.00
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJSËN RURALE-KAÇANIK	43,392.49	0.00	43,392.49	0.00
NDERTIMI I URAVE MBI LUMIN NERODIME DHE LEPENC	132,744.00	23,824.63	108,919.37	17.95
NDERTIMI I NENKALIMIT PER KEMBESORE NËN HEKURUDHEN E QYTETIT	119,803.45	26,633.75	93,169.70	22.23
NDËRTIMI I RRUGËS DHE TROTUARIT "RESHAT SHEHU"	72,279.00	0.00	72,279.00	0.00
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJSËN URBANE	150,000.00	13,664.47	136,335.53	9.11
RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJSËN RURALE	302,169.00	20,489.25	281,679.75	6.78
DREJTORIA E SHENDETËSISE DHE M.SOCIALE	245,000.00	4,313.64	240,686.36	1.76
FURNIZIMI ME APARATURA PËR QKMF	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
BLERJA E VETURËS PËR KUJDESIN PALIATIV	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
NDERTIMI I DEPOS DHE GARAZHËS NË QKMF	100,000.00	0.00	100,000.00	0.00
NDERTIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I OBJKTEVE PER BANIM SOCIAL	80,000.00	4,313.64	75,686.36	5.39
NDËRTIMI I OBJKTIT TË QPS-ËS NË KAÇANIK	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
DREJTORIA E KULTURES,RINISË DHE SPORTEVE	222,564.66	33,524.12	189,040.54	15.06
NDËRTIMI I STADIUMIT TË QYTETIT "BESNIK BEGUNCA"	6,607.10	0.00	6,607.10	0.00
NDËRTIMI DHE RIVITALIZIMI I MONUMENTEVE KULTURO-HISTORIKE	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
RREGULLIMI VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-SË	45,071.50	0.00	45,071.50	0.00
BLERJA E KOMBI BUSI PER NEVOJA TE RINISË, SPORTIT DHE KULTURES	60,000.00	33,524.12	26,475.88	55.87
RREGULLIMI I TERENEVE SPORTIVE TE PALESTRA	105,886.06	0.00	105,886.06	0.00

DREJTORIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS	617,106.00	64,848.20	552,257.80	10.51
FURNIZIM ME TABELA DIGJITALE PER SHKOLLAT FILLORE DHE TE MESME	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
NDËRTIMI I QERDHES SË FËMIJËVE NË KAÇANIK TË VJETËR	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
BLERJA DHE INSTALIMI I POMPAVE TERMIKE NE QEAP AGIMI	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
NDERTIMI I SHFMU - EMIN DURAKU- KAÇANIK	55,500.00	0.00	55,500.00	0.00
NDËRTIMI I QERDHES SË FËMIJËVE NË KAÇANIK TË VJETËR	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00
FURNIZIM ME TABELA DIGJITALE PER SHKOLLAT FILLORE DHE TE MESME	20,000.00	14,848.20	5,151.80	74.24
NDERTIMI I SALLËS SË EDUKATËS FIZIKE NE SHFMU IDRIZ SEFERI	200,000.00	0.00	200,000.00	0.00
NDERTIMI I SALLËS SË EDUKATËS FIZIKE NE SHFMU JUSUF GËRVALL	100,000.00	50,000.00	50,000.00	50.00
NDERTIMI I SALLËS SË EDUKATËS FIZIKE NE SHFMU NAZMI OSMANI	6,144.00	0.00	6,144.00	0.00
NDERTIMI I KULMIT TE SHKOLLES FILLORE "QAMIL ILAZI" NE KAÇAN	2,564.00	0.00	2,564.00	0.00
NDËRRIMI I KULMIT TË SHFMU "AGIM BAJRAMI" STAGOVË	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
VENDOSJA E ASHENSORIT NË GJIMNAZIN SKENDERBEU-KAÇANIK	2,898.00	0.00	2,898.00	0.00
NDËRTIMI I ANEKSIT TË IAAP- FERIZ GURI DHE VËLLEZËRIT ÇAKA	150,000.00	0.00	150,000.00	0.00
TOTAL SHPENZIMI JANAR-QERSHOR 2024	3,894,277.21	506,471.92	3,387,805.29	13.01

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Spektori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes se Mjedisit

- Kërkesa për kushte ndërtimi 31

-

1.1 Kushte ndërtimore të miratuara 26

1.2 Kushte ndërtimore në proces 5

- Kërkesa për leje ndërtimi 15

2.1 Të miratuara 11

2.2 Në procedurë 4

2.3 Nga Lejet e Ndërtimit, të cilat janë lëshuar: 4 i takojnë kategorisë së dytë

- Kërkesa për Legalizim 46

3.1 Të miratuara 24

3.2 Në procedurë 22

- Kërkesa për marrjen e pronave të komunës në shfrytëzim 10
- Kërkesa për këmbimin e pronave 6

Drejtoria ka lëshuar edhe:

4.1 Leje mjedisore komunale 5

4.2 Njoftime, Pelqime dhe shkresa te ndryshme 19

- Gjatë kësaj kohe janë kryer punime për përfundimin e projekteve të vitit 2023.

Kanë përfunduar këto projekte:

Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale
Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane
Rregullimi i shtretërve të përronjëve
Mbyllja e deponive ilegale

Projekti Ndërtimi i urës mbi lumin Nerodime është në përfundim e sipër.

Gjithashtu është lidhë kontrata dhe kanë filluar punimet për realizimin e projektit Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale për vitin 2024, kurse projekti Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane është në fazën e vlerësimit për përcaktimin e ndërmarrjes fituese.

Vlen të theksohet se si drejtori jemi ballafaquar me ndërrimet e destinimit të tokë bujqësore në tokë ndërtimore, për parcela të ndryshme, meqenëse PZHK-ja është në proces të hartimit.

- Kërkesa për ndërrim destinim të tokës Bujqësore në Ndertimore 34
 - 1.1 Kërkesa të miratuara 21
 - 1.2 Kërkesa të dorëzuara për Kuvend 4
- Drejtorja ka pranuar edhe 42 Vendime, Rekomandime, Raporte apo Shkresa të ndryshme nga Kuvendi i Komunës.
- Në Drejtori janë paraqitur edhe 81 kërkesa të ndryshme dhe 4 ankesa. Poashtu Drejtorja ka pranuar edhe 16 Kërkesa, Njoftime, Pelqime dhe Vendime të Ministrive dhe Gjykatave. Gjatë kësaj periudhe Drejtorja ka bërë 40 Kërkesa, Vendime, Njoftime apo Kërkesa të ndryshme.

Sektori i Kadastrit

Raporti i punës për gjashtë mujorin e vitin 2024

Gjatë këtij gjashtëmujori pranë nga 1 Janari 2024 e deri me 20 Qershor 2024 pranë sektorit të kadastrit kemi pranuar **dhe janë regjistruar 2328 lëndë duke i shtuar edhe lëndet e bartura nga viti 2023 afersisht 320 që në total janë 2648**, ku nga ky numër janë zgjidhur 2600 ndërsa në pritje për ekzekutim janë edhe 48 lëndë kryesisht të RDPP-së që kanë të bëjnë me bartje të pronave si dhe legalizime të objekteve të pranuar nga ana e palëve fizike apo juridike.

Ky sektor ka vazhduar me përpikmëri të bëjë implementimin e ligjit mbi themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së palujtshme Nr. 2002/5 dhe plotësimit të tij Nr.2003/13, si dhe ligjit mbi hipotekat Nr.2004/4.

Nga lëndët sa u përket Çertifikatave, Fletët Poseduese, Kopjet e Planit, Kordinatave gjeodezike etj të gjithat janë të kryera dhe të dorëzuara brenda afatit ligjor përkundër fluksit të madh të kërkesave nga palet përfshir kryesisht mërgimtarët që don të thot se nuk ka pasur ngecje në punë dhe palët kanë qenë të shërbyer në afatin optimal.

Në vazhdim kemi paraqitur llojet dhe sasin e kërkesave për secilen kategori veq e veq të cilat gjatë ekzekutimit në total kan gjeneruar të hyra afërsisht në shumën prej **38,552.50 € (euro)** dhe atë:

Sherbimet e ofruara sipas kërkesave të palëve:

• Fleta poseduese	867 lëndë
• Kopje të planit	260 lëndë
• Çertifikata të gjendjes së pasurisë	324 lëndë
• Koordinata gjeodezike	234 lëndë
• Identifikime	00 lëndë
• Të ndryshme (AKP, Gjykatat, K.K Kaçanik etj.)	05 lëndë
• Regjistri i RDPP-së	641 lëndë

Është vazhduar me Implementimin e Kadastrit digjital, ku është punuar në barazimin e pjesës grafike të Operatit Kadastral me atë tekstual.

Gjithashtu gjatë viti paraprak kemi implementuar edhe Udhëzimin Administrativ nr.03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy bashkshortëve. Ku përmes këtij udhëzimi bashkëshortët të cilët kanë shpreh vullnet që të regjistrojn pronën e paluajtshme si pasuri të përbashkët kanë qenë të liruar nga pagesa e taksave pranë zyreve kadastrale komunale. Ky udhëzim ka filluar te implementohet nga Marsi i vitit 2016 deri më Mars të vitit 2017, dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës ky afat është zgjatur edhe për një viti nga Prilli i viti 2017 deri ne vitit 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024. Është vazhduar me bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës në eliminimin e gjitha problemeve që kanë dalë gjatë punës së përditshme profesionale në këtë sektor, gjithashtu ky bashkëpunim është bërë edhe sa i përket trajnimit të mëtutjeshëm të personelit që është i angazhuar në kuadër të këtij sektori.

Në aspektin profesional është përkrahur Kuvendi Komunal në punët e shumë komisioneve siq janë: Komisioni për pranime teknike të projekteve, vlersimin e ofertave, etj.

Gjithashtu asistenca dhe bashkëpunimi profesional nuk ka munguar dhe ndaj institucioneve shtetërore siq janë: Agjencioni Kosovar i Privatizimit, Ministria e Infrastrukturës etj, ndërsa me informacione të ndryshme sipas kërkesës është përkrahur edhe Gjykata Komunale.

Sektorinë për qështje pronësore-juridike gjatë periudhës raportuese është marrë me punët dhe detyrat që i takojnë këtij Sektori dhe atë nga lëmia e uzrpimit arbitrar të Pronës Komunale dhe asaj publike. Shpronësimit, Mbajtjes së evidences së Pronës Komunale si dhe mënyrat e rregullimit të mardhënjeve pronësore-juridike, informata dhe raporte për organe të ndryshme.

Në kuader të legalizimeve kemi vazhduar me procesin e legalizimit te objekteve-ndërtesave dhe ekzekutimin e tyre në planet digjitale kadastrale dhe pjesen tekstuale te SIKTK-së sipas ligjit dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi mbi Legalizimet.

Duhet cekur gjithashtu se gjate viti 2021, 2022 dhe 2023 vazhdimisht kemi nje rritje enorme te lendeve ne RDPP-së duke perfshire Legalizimet e objekteve si dhe Elaboratin e Shpronësimit te Autostrades Prishtine – Shkup, dhe ofrimin e asistimit profesional edhe ne drejtorit e tjera ku si pasoj e numrit te vogel te stafit dhe ne munges te plotesiomit me staf te cilin e kemi kerkuar disa here nga drejtori i drejtoris se DUKMM – se kemi vonesa ne ezekutim te lendeve dha bartje te tyre ne vitin vijues.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

I. INFRASTRUKTURA

- **Asfaltime, ndërtime të rrugëve lokale, objekte dhe hapësira publike të financuara nga buxheti i komunës**

Gjatë kësaj periudhe, nga lista e investimeve kapitale me buxhetin e komunës janë kryer dhe janë në realizim projektet:

Nr.	Emërtimi	
1	Rregullimi i Sheshit të Qytetit - (kontratë 2 vjeçare)	<i>Në finalizim</i>
2	Ndërtimi i Objektivit për Zjarrfikësit – Kaçanik /faza II-të	<i>Në finalizim</i>
3	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Idriz Seferi”-Kaçanik	<i>Në realizim</i>
4	Rregullimi i ndriçimit publik	<i>Në realizim</i>

II. UJËSJELLËSI

- **Projekti “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit” është implementuar në lokacionet si më poshtë:**

Nr.	Emertimi	
1	Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit në lokalitetet Bajnicë, Ivajë dhe Kaçanik 2023-2024	<i>Është përmbyllë kontrata në vlerë 144,941.60€</i>
2	Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit në lokalitetin e fshatit Ivajë-faza II-të	<i>Në fazën e tenderimit</i>

III. KANALIZIME FEKALE DHE ATMOSFERIKE

- Me kontratën aktive për periudhën 2 vjeçare “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike”, këtë vit janë realizuar projekte në shumë: 67,394.63€. Në periudhën (6) gjashtë mujore të vitit 2024 janë imlementuar këto projekte:

Nr.	Emërtimi	
1	Sanimi dhe ripunimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në Runjevë-Lagje te Re pergjatë linjës së hekurudhës (4 lokacione: TMK, Kemal Thaqi, 2 përgjatë hekurudhes-Lagje Re	<i>E kryer</i>
2	Kanalizimi fekal në Dubrave-lagjja Vishaj-Kamishi /Te Shullani-vazhdim	<i>E kryer</i>
3	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal te rr.”Qendresa” dhe kyqja e rrjetit te lagjes Imishti me rrjetin e lagjes Memaj	<i>E kryer</i>
4	Ndërtimi i rrjetit te kanalizimit fekal në rr.”Mujedin Aliu”-Kaçanik i Vjetër	<i>E kryer</i>
5	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal ne lagjen Krraba-Stagovë	<i>E kryer</i>
6	Sanimi i defektit ne rrjetin e kanalizimit fekal te hekurudha Kaçanik i Vjetër	<i>E kryer</i>
7	Kanalizimi në lagjen Kukaj-Bob	<i>E kryer</i>
8	Sigurimi i 12 kapakëve për puseta të kanalizimit në rr.”Idriz Seferi”-Kaçanik	<i>E kryer</i>
9	Sigurimi i 100m gyp betoni Ø800 te Hetem Lama-Kaçanik i Vjetër	<i>E kryer</i>
10	Kanalizimi në lagjen Fejza-Begracë /mbetja te Perzhaj	<i>E kryer</i>
11	Kanalizimi fekal pergjate rruges alternative në Biqec	<i>E kryer</i>
12	Sigurimi i 50m gyp Ø315 per kanalizim atmosferik ne fshatin Duraj	<i>E kryer</i>
13	Pastrim i pusetave aktuale ne qytet (fekale dhe atmosferike)	
14	Vendosja e kapakeve te demtuar ne pusetat ekzistuese te kanalizimeve f&v	

- Kurse nga lista e investimeve kapitale të vitit 2024 është në realizim e sipër projekti 2 vjeçarë “Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Begracë” në vlerën e përgjithshme=322,259.12€

Nr.	Emërtimi	
1	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Begracë	Në finalizim

IV. PROJEKTE NGA GRANDI I PERFORMANCES KOMUNALE

- Mjetet e perfituara nga Grandi i Performances komunale në shumën= 552,104.38€ janë orientuar në realizimin e këtyre projekteve:

Nr.	Emërtimi	
1	Ndërtimi parqeve dhe hapësirave publike në lokacionet: Kaçanik i Vjetër dhe lagjja Hajdari- fshati Rekë	Në fazen e ritenderimit
2	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Stagovë-Runjevë	Ne fazen e ritenderimit
3	Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijences në SHMU”Nazmi Osmani”-Elezaj”	Në vleresim te ofertave
4	Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit	Në vleresim te ofertave
5	Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku, segmenti restorant Natyra – Fusha e Pajtimit.	Në vleresim te ofertave

V. MENAXHIMI I MBETURINAVE

- Me kompaninë private NT ”Krasniqi” është lidhur Marrëveshje për periudhën njëvjeçare 2024-2025 për operim të grumbullimit të mbeturinave në lokalitetet Begracë dhe K. Vjetër,
- KRM “Pastërtia”- njësia operative në Kaçanik ka zgjëruar operimin me mbulueshmëri të grumbullimit të mbeturinave edhe në lokalitetin e fshatit Koxhaj dhe janë futur në shërbim ekonomi familjare të reja në zonat e operimit,
- Mbulueshmëria më shërbim në komunën e Kaçanikut është mbi 98%.

VI. HAPËSIRAT PUBLIKE

➤ Gjelbërimi, Shetitoret dhe Parqet

Nr.	Emërtimi	
1.	Mirëmbajtje hapësirave të gjelbëruara me KRM "Pastërtia" sh.a	Në vijim
2	Rregullimi i Sheshit të qytetit –faza II-të	Në finalizim

VI. PARKINGJE

- Gjatë kësaj periudhe kujdes i veçant i është kushtuar menaxhimit të hapësirave për parkingje. Me Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së" (SH.I.L.-UÇK) është vazhduar me menaxhim të parkingjeve publike me pagesë në bulevardin "Ismajl Raka".
- Poashtu kemi vazhduar me lejin e parkingjeve me pagese vjetore në lokacionet: Banesa P+8, hapësira prapa kafiterisë "Egzona", rr."Qamil Ilazi" dhe hapësira përballë PTK-së.

VII. NDRIÇIMI PUBLIK

Projekti kapital "Rregullimi i ndriçimit publik"-shuma e projektit=39,323.35 € është duke u implementuar në këto lokacione:

1	Rregullimi i ndriçimit publik lagjja Mulaku- përreth N2-deri te Palestra e Sportit-Kaçanik
2	Rregullimi i ndriçimit publik te lagjja Dashi- fsh.Stagovë
3	Rregullimi i ndriçimit publik rr. "Murat Lika" -fsh. Strazhë (nga shkolla deri te lagjja)
4	Rregullimi dhe renovimi i ndriçimit te Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve
5	Rregullimi i ndriçimit publik në shetitoren III në Bulevardin "Ismail Raka" nga "Ura e Hazirit" deri te Xhamia e Dëshmorëve

VIII. PROJEKTE TJERA

Nr.	Emërtimi i projektit	
1	Krasitja e drunjëve dekorativ në bulevard, hyrje e qytetit dhe te Kompleksi i Varrezave te Dëshmorëve	E finalizuar me KRM"Pastërtia"
2	Rregullimi i ndriçimit publik në rrjetet ekzistuese të ndriçimit publik	E finalizuar

IX. MIRËMBAJTJE INVESTIVE

➤ **Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve lokale 2024**

- Mirembajtje e vazhdueshme e rrugëve lokale gjate sezonës dimerore dhe verore (largim i borës dhe hudhja e kripës industriale në rrugët lokale, pastrim i rrugëve nga rreshqitjet e dheut dhe gurëve, rehabilitim i rrugëve me shtresë asfalti, zhavori dhe kallëdermi, pastrimi dhe larje e bulevardit me autobot, etj.)

➤ **Mirëmbajtje ndriçimit publik**

- Mirëmbajtje rrjeteve ekzistuese ne zonën urbane dhe rurale të komunës përmes kontratës emergjente "Rregullimi i ndriçimit publik në rrjetet ekzistuese të ndriçimit publik" në shumë 6,592.30€.

➤ **Mirëmbajtje hapësirave të gjelbëruara**

- Pastrimi i shetitoreve në bulevardin "Ismajl Raka",
- Kositje e barit,
- Mirëmbajtje drunjëve dekorativ,
- Pastrim dhe mirëmbajtje e kompleksit të varrezave të dëshmorëve dhe lokacioneve të lapidarëve dhe busteve të dëshmorëve dhe Heronjëve të Kombit

➤ **Ekzaminimi i materialeve të ndërtimit**

- Marrje e mostrave të betonit, kubzave, skajoreve dhe asfaltit
- Matje e ngjeshmërisë së traseve të trotuareve dhe rrugëve

➤ **Mirëmbajtja e sinjalizimit H&V 2024**

Me anë të kontratës "Rregullimi i dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal" janë ekzekutuar punime të sinjalizimit në rrugë dhe lokacione të ndryshme të komunës:

- Rruga "Qamil Ilazi"-Kaçanik
- Rruga "Gllloboçicë - Gorancë"
- Rruga "Bob - Doganaj"
- Rruga "Shaban Elezi" dhe "Isen Elezi"- fsh. Sllatinë,
- Rruga "Mynyr Thaqi" në fsh. Kovaçec,
- Rruga "Hamzë Jashari"-Kaçanik
- Rruga "Ismail Raka"-Kaçanik
- Rruga te Qerdhja e Qytetit
- Kryqëzimi i rrugës kryesore të fsh. Nikaj dhe fsh. Biçec
- Rruga "Beteja e 25 majit" në fsh. Dubravë
- Rruga "Skenderbeu" - Kaçanik
- Rruga "Idriz Seferi" -Kaçanik
- Rruga e re te Sheshi i Qytetit
- Rruga "Agim Bajrami"-Kaçanik,

Me këtë rast është vendosur ky shenjzim vertikal dhe horizontal:

Sinjalizim vertikal

a. Shenja të rrezikut.....	9 copë
b. Shenja të urdhëresave të prera.....	12 copë
c. Shenja të lajmërimit.....	20 copë
d. Tabelë plotësuese.....	1 copë
e. Pasqyre.....	2 copë
f. Riparime te shtyllave dhe shenjave të dëmtuara.....	35 copë

Sinjalizim horizontal-material një dhe dykomponent

a. Shenjzim të vijës gjatësore	1495m
b. Shenjzim i llogos për shtigje të biçiklistave.....	21 copë
c. Zebra per kembesor.....	2 lokacione
d. Ngjyrosje e vijave te vendparkingjeve me ngjyrë të zezë.....	348m

Drejtoria e Bujqësisë Zhvillim Rural dhe Pylltarisë

Prioriteti 10: Zhvillimi i bujqësisë, krijimi i vendeve të reja të punës , rritjen e të ardhurave shtesë në zonat rurale dhe mbrojtja e pyjeve	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet /progresi/ performanca kyçe gjatë periudhës janar–qershor, të vitit 2024
<p>Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët dhe vendosja me kohë.</p> <p>Mbështetja e fermerëve, në kompletimin e dokumentacionit, për aplikim në projektet e subvencionimit të fermerëve nga MBPZHR dhe projekteve me mjete nga buxheti komunës</p>	<p>Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët dhe për vendosjen e kërkesave të tyre qytetarët janë informuar me kohë, jemi angazhuar në mbështetjen e fermerëve gjatë pranimit të aplikacioneve, duke i ofruar ndihmë në plotësimin e aplikacioneve me dokumentacione përcjellëse, gjatë aplikimit për subvencione në projektet e ofruara nga MBPZHR dhe në realizimin e projekteve me mjete nga buxheti komunës si dhe aktivitete tjera.</p> <p>Nga Projektet e ofruara të MBPZHR, për subvencionim të fermerëve, kët vit kemi 430 fermerë, që kanë aplikuar në zyrën e DBZHRP-së, në projektet e subvencionimit të MBPZHR (subvencionim të kulturës së grurit, misrit, kulturave pemëtare, perimore si dhe subvencionimit të fermerëve për lopë qumështore, deleve, dhive, bletëve si dhe shpezëve- pulave).</p> <p>Gjithashtu gjatë kësaj periudhe fermerëve ju kemi ofruar mbështetje lidhur me marrjen e informacioneve për plotësimin e dokumentacionit shtesë të kërkuara nga zyrtarët e MBZHRP sipas rasteve, për projektet e subvencionimit nga Ministria e Bujqësisë</p> <p>Si drejtori jemi angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes realizimit të projekteve të DBZHRP-së për subvencionim të fermerëve.</p> <p>Nga projekti mbështetja e fermerëve me shoqëri bletësh projekti veq është fazën përfundimtare të tenderimit, do të përfitojnë 40 bletarë nga pes(5) shoqëri bletësh.</p> <p>Nga projekti për mbështetje të fermerëve me serra kanë përfituar 100 fermerë serra në sipërfaqe prej 50m2, vlera e projektit 70,000.00€, projekt i</p>

	<p>realizuar me bashkëfinancim (të OJQ-ës Church Jezus Krisht 29,000.00€, buxheti Komunës 27,000.00€ si dhe participimi i fermerëve 20% vlerës së projektit 14,000.00€.</p> <p>Nga projekti për mbështetjen e fermerëve me freza 1.6m për tërheqje me traktor, që është vazhdimësi e projektit nga viti i kaluar, kanë përfituar 21 fermerë, vlera e projektit 15,582.00€. (buxheti komunal 12,465.60 €, (20% participimi i fermerëve 3,114.40€).</p> <p>Këtë vit kemi të planifikuar 60,000.00€ për ndërtimin e kanaleve të hapura të ujitjes në fshatërat: Dubrvë- lagja Vishaj, Vataj dhe Nikaj, projekti është në fazën e përmbjllëse të tenderimit. Gjithashtu kët vit kemi planifikuar mbështetjen e fermerëve me mekanizëm bujqësor : (freza për tërheqje me traktor, spërkatëse të grurit, kositëse, makina mbjellëse të misrit dhe grurit etj.)</p> <p>Me kërkesë të MBPZHR kemi hartuar raportin për mbjelljet pranverore të cilin e kemi përcjellur në MBPZHR, gjithashtu jemi në përcjellje të gjendjes së kulturës së grurit, pasi që tani jemi në fazën e pjekjes së kësaj kulture.</p> <p>Sa i përket kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, janë shqyrtuar 23 kërkesa, prej të cilave 22 janë të miratuara, 1 në proces</p> <p>Sipërfaqja e tokës bujqësore që është lejuar ndërrimi i destinimit është 24739 m² apo shprehur në hektar 2,47.39 ha. Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në shumë prej 12.556.00€.</p> <p>Me kërkesë të palëve janë lëshuar 60 vërtetime lidhur me numrin e koshereve me bletë, që posedojnë bletarët, për aplikim në subvencionet e MBPZHR, Janë inkasuar 6,000.00 €</p>
Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale	<p>Fermerët kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike me rastin e vizitave në terrenë, gjithashtu fermerët janë mbështetur me këshilla individuale sipas kërkesave së tyre, lidhur me vështirësit dhe problemet që i kanë përcjellur, gjatë këtij gjashtëmujori.</p>

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Janar

- Përgatitja e planit të punës për vitin 2024 dhe raporti i punës për vitin 2023
- Plotsimi i formularit në planin gjithpërfshirës të komunave në lidhje me obligimet e komunave nga agjenda evropiane në pjesën e trashëgimisë kulturore
- Shpërndarja e kontratave për përfituesit në projektin „Komunat për të Rinjë”
- Takim pune me Qendrën Rinore „Shtëpia e Shpresës” lidhur me bashkëpunimin e metutjeshëm me këtë organizatë
- Aplikimi dhe lëshimi i vërtetimit për Shkollën e Futbollit Avdurri
- Kemi punuar në finalizimin e raportit për vitin 2023 dhe planin e punës për vitin 2024
- Është punuar në raportin e monitorimit të subvencioneve në kulturë rini e sport për vitin 2023
- Është dorzuar propozim vendimi për KPF dhe kuvend për Emërimin e Këshillit Punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut
- Aplikimi dhe lëshimi i vërtetimit për regjistrim për shkollën e futbollit Almati
- Pjesmarrës në ceremonin e ndarjes së kontratave për përfituesit e projektit „Komuna për të Rinjë” organizuar nga MAPL
- Pjesmarrës në ceremonin e zgjedhjes së sportistit të vitit 2023 organizuar nga federata e motoqiklizmit të Kosovës
- Angazhim në plotsimin e formularit të raportit të strategjisë për vetqeverisje lokale për vitin 2023
- Angazhim në aktivitetin „Promovimi i artit dhe kulturës në qytetin e Kaçanikut” e organizuar nga Qendra Kulturore „Kaçaniku” dhe e mbështetur nga MKRS

SHKURT

- Pjesmarrës në seminarin Qeverisja Lokale dhe Dixhitalizimi-„Smart City”(Komunat e Mençura) e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës në Kulturë Rini e Sport
- Kanë filluar përgatitjet për shënimin e përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës
- Pjesmarrës në debatin me temë „Mundësia e realizimit të projekteve të përbashkëta në interes të shkollave dhe më gjërë” organizuar nga Drejtoria e Arsimit
- Pjesmarrje në trajnimin për menagjim të financave dhe prokurim në kuadër të projektit „Komunat për të Rinjë” organizuar nga CDF
- Stolisja e qytetit me flamuj për 17 Shkurtin-Përvjetori i 16-të i Pavarësisë së Kosovës
- Organizimi i turneut tradicional në futboll të vogël me nxënës të shkollave fillore „Kupa e Pavarësisë”
- Organizimi i kuizit të diturisë me moton „Rruga drejt Pavarësisë së Kosovës”
- Programi kulturor-artistik për nderë të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës
- Kontakti me përfituesit e nëngranteve në kuadër të projektit „Komunat për të Rinjë” dhe konfirmimi nga ata se kanë filluar me implementim të projektit pasi që janë ndarë mjetet edhe nga MAPL(15% nga komuna është ndarë në muajin dhjetor të vitit të kaluar)

- Pjesëmarrje në mbledhjen e KKSBB
- Pjesëmarrës në takim me grupin e performancës komunale
- Pjesëmarrës në Këshillin Punues të Muzeut
- Pjesëmarrës në puntorinë me temë „Plani strategjik dhe ngritja e fondeve për iniciativa të të rinjëve“-e organizuar nga USAID-Programi „Up to Youth“
- Shpallja e vendimit për shumën totale për subvencionimin OJQ-ve në lëminë e kulturës, rinisë dhe sportit si dhe publikimi në faqën e komunës
- Në bashkëpunim me shoqatën e pedagogëve të edukatës fizike janë mbajtur garat komunale në basketboll me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme
- Shërbim Festivalit të teatrove për Fëmijë-shfaqja teatrale „Shtëpia Magjike“-e shfaqur nga teatri „Adriana“-Ferizaj
- Pjesëmarrës në ceremoninë përmbyllëse të projektit 5 vjeçar „Up to Youth“ i implementuar në nëntë komuna të Kosovës ku pjesë e këtij projekti ishte edhe komuna jonë e organizuar dhe financuar USAID
- Përgatitja dhe publikimi i thirrjes publike për subvencione në kulturë, rini e sport
- Në stadiumin e qytetit Besnik Begunca është zhvilluar ndeshja ndërmjet KF Lepenci – KF Mitrovica .
- Në palestër përpos stërvitjeve të rregullta që kanë klubet sportive në bashkëpunim me Klubin e Mundjes Kaçaniku, Federatën e Mundjes së Kosovës dhe Drejtorinë e Arsimit bashkë me shkollat është bërë promovimi i sportit të mundjes.
- Shoqërimi i SHKA „Gryka e Kacanikut“ në manifestimin tradicional „Flakadani i Karadakut“-Viti
- Është vazhduar me punën në përpilimin e draft statutit të Muzeut të Qytetit
- Asistim në zhvillimin e garave shkollore në volejball
- Kemi pranuar aplikacionet e OJQ-ve për subvencione në kulturë, rini e sport dhe për anëtarë të komisionit të jashtëm për ndarjen e këtyre subvencioneve.

PRILL

- Angazhim në këshillin punues për Muzeun e Qytetit
- Komisioni ka filluar punën në vlersimin e subvencioneve në kulturë, rini e sport
- Kemi pranuar ftesë nga DKRS në Kamenicë për pjesëmarrje në manifestimin tradicional kulturor e sportiv „Lulëkuqet e Prillit“ që ju kushtohet betejës së Marecit ku komuna jonë do të prezantohet me program folklorik nga SHKA „Tingujt e Vendlindjes“.
- Në bashkëpunim me Federatën e Mundjes së Kosovës e në mbështetje të Klubit të Mundjes „Kaçaniku“ u organizua Kampionatin Individual i Kosovës për grupmoshën U15 dhe U20 në Palestrën e Sportit .
- Pjesëmarrja e të rinjëve në punëtorinë „Rritja e ndërgjegjësimit dhe luftimin e ndotjes së ajrit në komunitet“-organizuar nga organizata PEN, punëtori 3 ditore.
- Aktivitetet sportive në bashkëpunim me FFK-në dhe Shoqatën Handikos për personat me aftësi të kufizuara .
- Pranimi i donacionit , mjete për punë nga USAID-Programi Up TO YOUTH për KVRL.
- Vizitë muzeut të qytetit të Pejës me këshillin punues të muzeut të Kacanikut
- Përgatitja e rekomandimit dhe njoftimit për përfituesit në subvencionet e kulturës ,rinisë dhe sportit
- Takim pune me zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me mundësinë e mbajtjes së një ligjerate me të rinjë ku si temë e kësaj ligjerate do të jetë „Drejtësia Tradicionale
- Angazhim në organizimin e një aktiviteti për të rinjë, „Dita Ndërkombëtare e Librit“

- Takim me organizatën CDF dhe përfituesit nga cikli i parë dhe i dytë në lidhje me praktikat e mira të grupit përfitues në ciklin e parë si dhe gjendja aktuale e përfituesve në ciklin e dytë në lidhje me projektin „Komuna për të Rinjë”
- Në bashkëpunim me Federatën e Mundjes së Kosovës, organizimi i Turneut Memorial Heroinat e Kaçanikut.
- Formimi i komisionit të ankesave në kuadër të thirrjes publike subvencione në kulturë,rini e sport
- Angazhim në shënimin e 22 prillit-Dita Ndërkombëtare e Tokës
- Përgatitja e materjalit të punës për KKSB
- Takim pune me Këshillin Punues të Muzeut

MAJ

- Shërbim kryqit të kuq komunal në zhvillimin e garave regjionale të ndihmës së parë të mbajtura në Palestren e Sportit
- Është mbajtur diskutim publik për draft statutin e muzeut .
- Pjesëmarrja e Qendra Kulturore në Festivalin Anadrini Jehon
- Pjesëmarrja e SHKA Tingujt e Vendëlindjes në gjirime në njëri nga TV tona vendore.
- Organizimi i garave regjionale/ kampionale në bashkëpunim me Federatën e Volejbollit të Kosovës për U14 në Volejball
- Kan vazhduar nënshkrimet e kontratave për përfituesit në subvencionet e kulturës,rinisë dhe sportit të thirrjes së parë publike
- Pjesmarrës në mbledhjen e parë të këshillit organizativ për shënimin e 25 vjetorit të Çlirimit të Kacanikut me rrethinë
- Organizimi i finaleve në futboll për grupmosha të reja në Stadiumin Besnik Begunca në Stagovë, nga Lidhja Rajonale e Futbollit në Ferizaj.
- Takime me klube sportive rreth shënit të 11 Qershorit –Ditës së Çlirimit të Kaçanikut.
- Takim me organizatën KDI lidhur me mundësinë e pjesmarrjes së të rinjëve nga komuna jonë në akademinë dy dytore kundër-korrupsion
- Pjesmarrës në forumin e informimit dhe vetedijesimit publik me të rinjët/adoleshentët e Kacanikut organizuar nga USAID , ku si temë ishte Legjislacioni mbi pronësinë përmes trashëgimisë
- Takim me këshillin themelues të Muzeut të Kacanikut dhe me pronarin e gurit përkushtimor në Kotlinë lidhur me mundësinë që ky artefakt të ju dorëzohet muzeut e që rezultoi si takim i sukseshëm
- Pjesmarrës në përrurimin e projektit kabineti i teknologjisë informatike në HANDIKOS- në kuadër të programit „Komunat për të Rinjë”
- Pjesmarrës në mbledhjen e dytë të këshillit organizativ në lidhje me aktivitetet e 11 qershorit.
- Finalja e Turneut Memorial DIKI 2024, e zhvilluar ne Palester .
- Perfundimi i dates per aplikim per subvencione ne fushen e cultures, rinise dhe sportit dhe pranimi i aplikacioneve ne thirjen e dyte publike.
- Takim me KFOR-amerikan ku si temë e takimit ka qenë aktivitetet e të rinjëve
- Përgatitjet për shënimin e 1 Qershorit-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve
- Pjesmarrës në Komisionin për ndarje të subvencioneve në Kulturë rini e sport-faza e dytë si dhe përgatitja e njoftimit për përfituesit e këtyre subvencioneve

- Angazhim në sigurimin e stellës përkushtimore në fshatin Kotlinë dhe vendosja e sajë në shtëpinë e kulturës
- Miratimi i Draft statutit të Muzeut nga Kuvendi Komunal

Qershor

- Shënimi I 1 Qershorit –Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve
- Janë bërë përgatitjet e fundit për shënimin e aktiviteteve në kuadër të 25 vjetorit të ditës së Çlirimit
- Është bërë vendimi dhe kontratat e përfituesve të subvencioneve në kulturë,rini e sport-faza e dytë
- Është shënuar Dita Ndërkombëtare e Sportit dhe Mjedisit
- Angazhim në stolisjen e qytetit me flamuj si dhe shpërndarja e njoftimeve për aktivitetet e ditës së Çlirimit
- Është mbajtur Turnir mbarëkombëtarë i shahut në kuadër të aktiviteteve të Ditës së Çlirimit
- Është bërë publikimi i raportit dhe dokumenteve përcjellëse të diskutimit publik në lidhje me Draft Statutin e Muzeut
- Angazhim shënimin e të gjitha aktiviteteve në kuadër të 25 vjetorit të ditës së qlirimit
- Është bërë përrurimi I tereneve sportive të jashtme te Palestra Sportive .
- Pjesmarrës në komisione për rekrutim
- Pjesmarrja e Qendrës Kulturore në festivalin tradicional folklorik në Deqan
- Angazhim në organizimin e ekranit të hapur në përcjelljen e ndeshjeve të kampionatit evropian në futboll.
- Ekspozitë „Kolonja artistike Shtrazë”organizuar nga artistët e Kolonisë së Artit pamor

SHËNIM:

- Janë organizuar e ndihmuar në këtë gjashtë mujorësh edhe një varg aktiviteteve e programesh të tjera në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” në Kaçanik, mbi bazën e kërkesave të grupeve dhe shoqatave të ndryshme joqeveritare;
- Pjesëmarrje dhe angazhim në çdo përvjetor ,vizitë pllakave të të rënëve;
- Në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor janë organizuar gara në të gjitha lëmitë sportive (meshkuj,femra) ku vendet e para kanë përfaqësuar komunën tonë në garat regjionale;
- Klubet Sportive kanë vazhduan aktivitetet e tyre garuese aty ku parashihen garat në Ligat përkatëse të Kosovës në sezonin pranveror ndërsa disa klube janë duke marrur pjesë në turne të ndryshëm mbrenda dhe jashtë Kosovës të organizuara nga Federatat Përkatëse;
- Pjesëmarrës dhe të angazhuar direkt në komisione të ndryshme në Komunë;
- Aktivitete sportive të vazhdueshme me shoqatën HANDIKOS;
- SHKA-të janë duke vazhduar me aktivitete të shumta në komunën tonë, poashtu kanë marrë pjesë edhe në festivale të ndryshme garuese dhe festive.
-

ORGANIZATAT KULTURORE, RINORE E KLUBET SPORTIVE

Sipas thirrjeve publike organizatat kulturore , rinore dhe klubet sportive janë përkrahur me subvencione, të ndara nga komisioni i themeluar perkatës:

Përfituesit :

1. Klubi Futbollit "Lepenci"
2. Fondacioni Bonevet,
3. Klubi Basketbollit "Kaçaniku",
4. Klubi Futbollistik i Femrave "Bazelli 2015"
5. Klubi Mundjes "Kaçaniku"
6. Klubi Taekëondos "Kaçaniku"
7. Klubi Volejbollit "Kaçaniku" (femrat)
8. Klubi Volejbollit "Kaçaniku" (meshkujt),
9. Këshilli Veprimit Rinor Lokal.
10. Motokros "Kaçaniku",
11. Qendra Kulturore "Kaçaniku",
12. Shoqata Bjeshkatore Alpiniste "Kaçaniku 2015",
13. Shoqëria Kulturo Artistike "Tingujt e Vendëlindjes",
14. Shoqëria Kulturo Artistike "Gryka e Kaçanikut",
15. Shoqata e Peshkatarëve Rekretativo Sportiv "Trofta e Lepencit
16. Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor.
17. Klubi i shahut „Lepenci"
18. Shoqata Kuflla e Gurit
19. Klubi i Ping-Pongut Kaçanikut
20. OJQ –Kampi i Artistëve Mural
21. Klubi i Basketbollit " Lepenci "

OBJEKTET KULTURORE, RINORE E SPORTIVE

Angazhimet dhe kërkesat e DKRS-së për infrastrukturën sportive në komunën tonë drejtuar Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit edhe këtë vit nuk kanë munguar, mirëpo sivjet nuk kemi patur asnjë investim dhe nuk kanë vazhduar punimet në ndërtimin e tribunave në Stadiumin e Qytetit "Besnik Begunca", edhe pse me kërkesë të MKRS, ne me kohë kemi shkëputur kontratën me punëkryesin e mëhershëm si dhe kemi bërë prerjen e punimeve , dokumentacion të cilin ua kemi përcjellë edhe ministrisë bashkë me kërkesën për vazhdim të punimeve, mirëpo deri më tani nuk kemi marrur ndonjë përgjigje.

Punimet në ndërtimin e fushave sportive të jashtme (hendboll, basketboll, volejball, tenis, dhe staza e vrapimit) në hapësirën e Palestrës Sportive ka përfunduar dhe përfundimi është bërë më 11 Qershor 2024. Gjithashtu në këtë gjashtë muaj kanë filluar punimet edhe për ndërtimin e terenit sportive-fushë futbollit në fshatin Gllloboqicë, project ky i cili financohet nga Komuna e Kaçanikut.

Në Shtëpinë e Kulturës Xheladin Kurtaj edhe gjatë vitit 2024 drejtorja dhe stafi mbështetës i sajë u angazhua për kryerjen e punëve, shërbimeve dhe detyrave tjera, si:

- Përkujdesja e vazhdueshme dhe mirëmbajtja e objekteve të kulturës;
- Ofroi shërbim për lexues dhe për të gjitha asociacionet lokale, për aktivitetet e tyre jokomerciale kulturore-artistike, letrare, përkujtime, politike, fetare, humane, sportive, garuese e manifestime të tjera;

Drejtorja për Kulturë, Rini e Sport gjatë takimeve në kolegjiun e drejtorisë së kulturës, rinisë dhe sporteve paraqiti edhe kërkesën për renovimin e Shtëpisë së Kulturës Xheladin Kurtaj dhe pas kontakteve të vazhdueshme me departamentin e kulturës në MKRS është kërkuar qëndrueshmëria e objektit në fjalë ku me këtë rast MKRS kërkesës sonë iu është përgjigjur pozitivisht dhe shpresojmë se projekti për renovimin e Shtëpisë së Kulturës të realizohet në bashkëpunim me komunën dhe MKRS.

Gjithashtu është në përfundim e sipër projekti për rregullimin e Kompleksit Memorial të Varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-së.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm duke u bazuar në Planet strategjike komunale si dhe në Planin e punës për vitin 2024, ka vazhduar aktivitetin dhe punën e saj duke u munduar që në krye të prioriteteve dhe në fokus të veçantë të ketë mirëqenien e qytetarëve të Komunës tonë.

Përkundër sfidave të vazhdueshme në aspektin e qështjeve ekonomike, DZHET ka arritur që të zbatoj planin e punës të paraparë për këtë vit dhe të kryej detyrat me përgjegjësi të cilat janë në kompetencën e saj.

Të gjitha aktivitetet të cilat janë realizuar dhe ato të cilat janë në proces e sipër i gjeni të bashkëngjitura në këtë raport gjashtë mujor.

Në kuadër të drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit funksionon : Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit si dhe Qendra Komunale për Regjistrimin e Biznesit .

Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Komuna e Kaçanikut është njëra ndër komunat me potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim të turizmit në Kosovë e sidomos turizmit malor. Ne jemi duke u munduar në vazhdimësi që këtë potencial ta promovojmë përmes bashkëpunimeve dhe projekteve konkrete, ta nxisim zhvillimin ekonomik dhe promovimin e vlerave historiko-kulturore dhe natyrore të vendit tonë.

Gjatë këtij viti nuk ka munguar bashkëpunimi me komunat tjera ,nivele qendror si dhe me akter të ndryshëm dhe organizata joqeveritare si :AZHR-Lindje ,Demos, USAID, GIZ-in Gjerman si dhe me KFOR-in me qëllim të shkëmbimit të përvojave. Kryesisht këto bashkëpunime janë konkretizuar me marrëveshje bashkëpunimi më shumë në fushën e turizmit.

Vlenë të theksohet se këtë vit Komuna e Kaçanikut dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për bashkëfinancim të projektit “Ndërtimi i objektit kullë për vizitor tek bashkimi i dy lumenjve “. Projekt ky i cili do t’i kontribuojë zhvillimit të turizmit në vend. Ky projekt është mbështetur me shumën 60,000.00€.

Komuna e Kaçanikut dhe Komanda e Rajonit Perëndimor e KFOR-it së fundmi kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në fushën e turizmit . Marrëveshja përfshinë bashkëpunimin ndërmjet Komunës tonë, KFOR-it si dhe universitetet: “Haxhi Zeka” në Pejë, “Ukshin Hoti “ Prizren si dhe universitetin ”Fehmi Agani “në Gjakovë .

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe Komuna e Kaçanikut dhe USAID kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në aktivitetin “Qeverisja e pronës “ dhe në kuadër të kësaj janë mbajtur disa punëtori me gratë ndërmarrëse sa i përket aktivitetit për qeverisjen e pronës ,qasja më e lehtë në financa si dhe ndihmesa sa i përket hapjes, dhe zhvillimit të biznesit. Gjithashtu në kuadër të këtij memorandumit është themeluar ” Këshilli publiko-privat” që për qëllim ka bashkëpunimin e Sektorit privat me Institucionet komunale .

Kanë vazhduar bashkëpunimet me Drejtorinë për Planifikim dhe Menaxhim të Parkut Nacional “Sharr”, në kuadër të kësaj, ne kemi dërguar propozimet tona të cilat duhet të përfshihen në Planin e ri Kombëtar për

Parkun Kombëtar "Sharr". Propozimet tona lidhen me zhvillimin e turizmit në këtë pjesë dhe krijimin e një zone të re turistike të qasshme me infrastrukturë dhe projekte të tjera të nevojshme për zhvillimin e kësaj pjese

AZHR-Lindje dhe Komuna e Kaçanikut në kuadër të bashkëpunimit shumëvjeçar, këtë vit do të realizojnë një projekt që kryesisht ka të bëjë me promovimin e turizmit në Komunën tonë.

Gjithashtu bashkëpunimi nuk ka munguar me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë , Departamentin e Turizmit ,që kryesisht kanë qenë bashkëpunime në hartimin e dokumenteve të rëndësishme strategjike zhvillimore.

Në kuadër të politikave tona zhvillimore ekonomike, ku si prioritet kemi rritjen e numrit të të punësuarve, jemi duke identifikuar edhe disa hapësira të përshtatshme për krijimin e zonave për vendosjen e parqeve industriale ,inkubatorë biznesi dhe zonat të reja turistike me qëllim të ofrimit të kushteve infrastrukturore për investitor dhe nxitjen e tyre për investim në Komunën tonë. Përmes këtij procesi presim shtim të numrit të vendeve të reja të punës si dhe rritje të zhvillimit ekonomik në komunën tonë.

Përmes pronave të cilat mund të jepen për shfrytëzim, jemi duke u munduar të kontaktojmë investitorë potencial, me qëllim që t'i njoftojmë për kushtet e krijuara në fushën e të bërit biznes në Komunën tonë. Kemi pasur disa kërkesa nga investitorë të ndryshëm , vlen të cekët që këtë vit është nënshkruar kontrata me një investitor si dhe disa të tjera janë në proces dhe pritet të marrin aprovimin nga Kuvendi Komunal. Edhe në këtë periudhe ka vazhduar aplikimi i taksës zero për ushtrim të veprimtarisë së bizneseve si dhe normës minimale për biznese në tatim në pronë.

Shfrytëzimi i lokaleve në pronësi të komunës të cilat jepen për bizneset në komunën tonë do të mbetet falas deri në një vendim tjetër, me qëllim që të përkrahen bizneset lokale. Gjithashtu Komuna e Kaçanikut është në proces të hartimit të "Planit Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal" ku është formuar Grupi punues dhe momentalisht jemi në fazën e grumbullimit të të dhënave, konkretisht analizën e gjendjes aktuale, plotësimin e pjesës së sfondit.

Ne si drejtori në kuadër të aktiviteteve tona kemi zhvilluar disa takime me bizneset që veprojnë në komunën tonë, në mënyrë që të njihemi më shumë me nevojat dhe sfidat me të cilat përballet sektori ynë privat .

Për kundër vështirësive që kemi hasur gjatë rrugës, si pasojë e krizës globale dhe gjithashtu mundësive të kufizuara financiare të Komunës sonë, megjithatë janë zhvilluar dhe janë në proces shumë punë të mira për Komunën dhe qytetarët tanë.

Nga puna jonë e përbashkët në këtë drejtori me fillimin e veprimtarisë së saj, është bërë identifikimi i nevojave dhe projekteve të mundshme të cilat do të krijojnë dhe mundësonin një zhvillim më të mirë dhe më të qëndrueshëm lokal dhe të turizmit në përgjithësi. Marrë për bazë se për shkak të pozitës gjeografike , relievit kodrinoro- malor dhe natyrës së saj piktoreske, komuna jonë ka potencial të jashtëzakonshëm të zhvillimit të turizmit malor, andaj edhe puna jonë është e fokusuar në këtë drejtim.

Projektet kapitale

- Projekti me titull sipas kontratës: "Ndërtimi i shkallëve për ngjitje mbi Gurin e Shpuar" me numër identifikues: KA652/23/010/521, implementimi i këtij projekti ka filluar në vitin 2023 dhe punimet janë duke vazhduar edhe në këtë vit, në të cilin vit është planifikuar të përfundojnë punimet, deri më tani është arritur të ekzekutohet rreth 48% e vlerës së projektit, gjegjësisht punimeve të kryera, tani jemi në fazë të muratimit të mureve anësore me gurë natyral dhe shtrimin të shkallëve dhe pushimoreve nga pllakat gjithashtu nga guri natyral, punimet janë duke u zhvilluar sipas dinamikës së paraparë, përkundër vështirësive për shkak të terrenit të papërshtatshëm dhe jashtëzakonisht të vështirë për punë.
- Projekti me titull sipas kontratës : "Ndërtimi i parkut rekreativ në zonën turistike në fshatin Shtrazë " me numër identifikues: 652-23-6713-5-2-1, ky projekt ka qenë i planifikuar të realizohet në vitet 2023-2024, tani është në fazë të përmbylljes së punimeve, pothuajse janë përfunduar të gjitha punët e parapara për ndërtimin e këtij parku, vlera e punimeve të kryera sipas kontratës bazë është 107,317.78 € dhe aneks kontrata 8,280.23€.
- Projekti me titull sipas kontratës : "Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriçimit publik" në rrugën " Murat Lika," në Strazhë, me numër identifikues: 652-23-2430-521, ky projekt ka qenë i planifikuar të realizohet në vitet 2023-2024, janë përfunduar punët e gërmimeve, zhavorit, ndërtimit të mureve mbrojtëse, montimit të gurëve skajor nga betoni, dhe shtrimi me kubëza i një pjese të trotuarit, është bërë faza e parë e ndriçimit publik, hapja e kanalit montimi i kabllor dhe punimi i themeleve të shtyllave të ndriçimit. Në ditët në vijim do të punohet shtresa e asfaltit, sinjalizimi horizontal dhe montimi i shtyllave elektrike të ndriçimit së bashku me trupa ndriçues. Sipas vlerës së punimeve të kryera deri më tani është ekzekutuar 55% e vlerës së projektit, mirëpo si projekt pritet të përfundojë shumë shpejt, për arsye se ekzekutimi i punimeve të mbetura për shkak të natyrës së punëve është i shpejtë dhe nuk merr shumë kohë për përfundimin e tyre.
- Projekti kapital me titull "Ndërtimi i objektit kulle për vizitor tek bashkimi i dy lumenjve " me numër identifikues 652-24-1066-5-2-1 projekt ky i cili është mbështetur me shumën 60,000.00€ nga MZHR. Është lidhur kontrata me Operatorin Ekonomik në vlerë 67,845.67€ .Projekti është në fazën fillestare të punimeve dhe pritet të përfundojë këtë vit.

Jemi në proces të tenderimit të projektit kapital "Shtegu i Lirisë " faza I, shuma e planifikuar për këtë projekt është 75,000.00 € dhe këtë vit për këtë projekt është ndarë shuma 40,000.00 euro .Projekti pritet të implementohet gjatë vitit 2024-2025 në periudhë një vjeçare.

Qendra Komunale Për Regjistrim të Biznesit

Në funksion të biznesit lokal ekziston Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve. Përmes kësaj qendre komuniteti i biznesit për një periudhë të shkurtër mund të regjistrojnë apo themelojnë veprimtarinë biznese. Po ashtu përmes saj bëhet edhe ofrimi i informatave për investitorët potencial, gjithashtu jepen këshilla ndaj bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese në plotësimin e aplikacioneve të ndryshme sipas nevojës, me qëllim të qasjes më të lehtë në financa apo mjete fikse që mund të përfitohen nga donatorët e ndryshëm.

Kjo zyre ka një bashkëpunim të veçantë me Agjencinë për Regjistrim të Biznesit të Kosovës ku kontakti ynë me këtë institucion është pothuajse i përditshëm .

Këtë vit kemi pasur rritje të numrit të bizneseve të reja të regjistruara krahasuar me vitin e kaluar në periudhën e njëjtte kohore nga 66 sa ishin vitin e kaluar në 77 biznese të reja të regjistruara . Bizneset e regjistruara kanë qenë 55- SH.P.K (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) dhe 22 Biznese Individuale. Nga këto shifra 60 biznese menaxhohen nga meshkujt ndërsa 17 nga femrat.

Gjatë periodës raportuese, kjo zyre ka pranuar gjithsej 246 lëndë të cilat në afatin ligjor ka shqyrtuar të gjitha lëndët e pranuar.

Qendra komunale për regjistrimin e biznesit	
Lloji i kërkesës	Numri
Biznese të reja	77
Shuarje të biznesit	07
Ndryshime në biznes	13
Certifikatë dublikat	15
Informata të biznesit	126
Vërtetim për tender	08

Veprimtaritë e bizneseve të reja kanë qenë të ndryshme por më shpeshta kanë qenë, shih tabelën më poshtë:

Bizneset sipas llojit të veprimtarisë /aktivitetit	%
Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike	8
Aktivitete shërbyese të pijeve	8
Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore	7
Prodhimi i mobilie dhe kuzhinave	7
Tregtia me pakice e bukës, ëmbëlsirave produkteve nga mielli në dyqane të specializuara	7
Punime suvatimi	7
Aktivitetet tjera shërbyese të ushqimit	7
Aktivitete të tjera në përqindje me të vogël	49
Totali	100%

Subvencionimi :

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET) në Komunën e Kaçanikut, në bazë të të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve në Komunën e Kaçanikut, në kuadër të Programit " Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla është në procedurë të shpalljes së thirrjes publike për aplikim për mbështetje të bizneseve lokale mikro dhe të vogla.

Qëllimi i Programit "Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla", ka për synim fuqizimin ekonomik të bizneseve lokale, përkatësisht promovimin dhe rritjen e tyre.

Ky fond do të nxisë dhe mbështesë zgjerimin e bizneseve për punësim kryesisht të grave dhe të rinjëve.

Interes i veçantë i kushtohet projekteve që kanë mundësi të zëvendësojnë importet dhe të krijojnë eksporte që mbulojnë nevojat dhe prioritetet e mjedisit lokal.

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi

